



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në:
“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”
Universiteti i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Olimpjon SHURDI

Prof.Asoc. Elson AGASTRA

Shkurt / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Teknologji Informati dhe Komunikimi"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në "Teknologji Informati dhe Komunikimi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr 568, datë 14.07.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Urdhër Nr. 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2021 - 2022:	18 PAE /16 PAK Ngarkesa mësimore: 78.3 % PAE / 21.7 % PAK
16	Numri i studentëve (2018-2021):	2019-2020 102 studentë; 2020-2021 102 studentë; 2021-2022 101 studentë;
17	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është një Institucion publik i arsimit të lartë, më i vjetri dhe më i madhi në vendin tonë dhe i krijuar në vitin 1957. Institucioni është ri akredituar me vendim nr. 84 datë 27.10.2018, të Bordit të Akreditimit me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri me 26.10.2022. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 6 Fakultete dhe 2 Institute. Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga 8 departamente ku përfshihet edhe Departamenti i Informatikës.

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Informatikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, dhe është lincësuar me VKM. Nr. 568, datë 14.07.2010. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit të Tiranës për aplikim për akreditimin e programeve të studimit drejtuar ASCAL-it, më datës 26.10.2021, Nr. 2837 Prot.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit Europian të Transferimit të Krediteve në 180 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përftohet Diplomë Universitare Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”.

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Informatikës duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të formojë specialistë me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e informatikës, Teknologjisë së Informacionit, shkencave kompjuterike, në përputhje me nevojat zhvillimit të vendi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informatikoni dhe Komunikimi”.

Bazuar në Urdhër nr. Nr.68, Datë 10.06.2022, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti i Tiranës, grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Asoc Olimpjon Shurdi dhe Prof. Asoc Elson Agastra. Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Maj 2022 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Tiranës (UT) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti i Tiranës, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 5 dhe 6 Korrik 2022, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Informatikës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/188 Prot, datë 27.12.2022. Universiteti i Tiranës më datë 25.01.2023, njofton nëpërmjet sistemit AMS, mbi dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Shënimet e takimeve), GVJ arrin në gjykimin se programi i studimeve i Ciklit të parë Bachelor (Ba) në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” i ofruar nga i Departamenti i Informatikës (DI) (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, FSHN) në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program bashkëkohor dhe koherent ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti. Fusha e programit të studimit është në përputhje me misionin, strategjinë e Universitetit të Tiranës si dhe strategjisë kombëtare të zhvillimit të teknologjisë së informacionit në vend.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 5], [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i statutit të Universitetit të Tiranës dhe Planit Strategjik të tij, GVJ vlerëson se programet e studimit, përfshirë programin Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ndër të tjera Universiteti i Tiranës synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare.</p> <p>[Evidenca 1, Statuti i Universiteti i Tiranës , Neni 5] [Evidenca 4, Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023]</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe</p>

qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.</p> <p>[Evidenca 4, Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023]</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës , Neni 5]</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Gjatë studimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni GVJ konstaton se programi i Ciklit të Parë të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” është hapur në vitin akademik 2010-2011, nuk evidentohet ndonjë studim paraprak, megjithatë kërkesat e tregut për specialist të fushën Teknologjisë së Informacionit janë gjithmonë në rritje. Në rregulloren e programit të studimit evidentohet se <i>qëllimi i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ”</i> është të jap njohuri bazë në fushën e teknologjisë së informacionit, inovacionit dhe komunikimit. Ky program studimi synon të përmbush kërkesat e tregut të sotëm të punës, duke u mundësuar të diplomuarve të punësohen në administratën publike e private, në korporata bankare, korporatat e telekomunikacionit, si dhe në shumë institucione tjera të kësaj natyre brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK],</p> <p>[Evidenca 10 - Studimi i Tregut të Punës UT 2018]</p> <p>[Evidenca 11 - Studimi i Tregut të Punës Janar 2022].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjik, midis të tjerash, cilësinë dhe performancën akademike, kërkimin shkencor dhe inovacionin si dhe reformën kurrikulare në dy drejtime rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe hapja i kurrikulave të reja. Përmbushja e misionit të Universitetit të Tiranës (UT) planifikohet të realizohet dhe duke siguruar</p>





	shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit. [Evidenca 4 - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023]			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i UT përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Një nga drejtimit prioritar akademike të UT është “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” me të cilin përputhet fusha e studimit të programit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Informatikës, që kanë në përgjegjësi realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimit”, koordinojnë me efikasitet progresin e tyre me Planin Strategjik të Institucionit dhe me rregulloret specifike të tyre. [Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës , Neni 8, Pika 1, 2, 3, 4], [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës], [Evidenca 4 - Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023], [Evidenca 5 - Strategjia e Departamentit të Informatikës, Evidenca 6 - Rregullore e UT]			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimit” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit Institucioni, i mbështetur gjithashtu në disa Strategji Kombëtare, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën e teknologjisë se informacionit, sisteme informatike, atë të përpunimit dhe të transmetimit dixhital te informacionit, sisteme informatike etj. Në strategjinë e tij, UT ka përcaktuar qartë objektivat në planin afatgjatë të zhvillimit të tij, të cilat janë kërkesa bashkëkohore si për stafin akademik ashtu edhe kërkesa për brezin e ri të specialisteve në TIK. [Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës , Neni 7, Pika 3], [Evidenca 4 - Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023], [Evidenca 5 - Strategjia e Departamentit të Informatikës] [Evidenca 6 - Rregullore e UT]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Objektiva të programit të studimit mund të veçojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitjen e studentëve me njohuritë bazë mbështetëse teorike në funksion të teknologjisë së informacionit; • Njohjen e studentëve me teknologjitë konkrete që përdoren së fundmi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; • Njohjen e studentëve me bazat e konceptimit dhe implementimit të harduerëve mbështetës të sistemeve informatike; • Aftësimin e studentëve në analizimin kritik të sistemeve të biznesit, me qëllim përmirësimin e tyre me anën e sistemeve të informacionit; • Studentët të fitojnë aftësi për të komunikuar qartësisht me shkrim apo nëpërmjet prezantimeve koncepte teknike; • Përgatitja e studentëve me aftësitë e nevojshme të komunikimit për integrim në skuadra pune në sektorë multidisiplinarë; <p>Programi i studimit ofron në përgjithësi të gjitha aftësitë dhe njohuritë që organizohen sipas skemës së llojit të lëndëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, duke shfrytëzuar modele të programeve të ngjashme të universiteteve perëndimore, duke synuar në përgatitjen e një brezi të specialisteve të TIK por dhe programues duke synuar në një fushë më të gjerë të lëndëve që mund të trajtohen në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK], [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK], [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes DVV, në raportin e përgatitur nga UT në vitin 2018 del qartë kërkesa e madhe në vend për specialist në fushën e teknologjisë së informacionit dhe</p>

<p>programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>IT-së, inxhinierisë kompjuterike, të inxhinierisë software dhe të sistemeve digjitale të përpunimit dhe transmetimit të informacionit. Kryesisht institucioni është mjaftuar në ndjekjen dhe gjurmimin e studentëve të punësuar të cilët janë diplomuar në vitin 2021 në këtë program studimi. Bazuar në këtë dokument të institucionit, rezultojnë një numër prej 15 nga 37 të diplomuar student të punësuar në përputhje me diplomën, por nuk jepen burime të të dhënave mënyrën e mbledhjes së tyre dhe besueshmëria.</p> <p><i>Institucioni nuk ka paraqitur studime të mirëfillta të kërkesave të tregut bazuar në këtë fushë ndoshta edhe periudha e pandemisë, por edhe kërkesa e lartë që ekziston në treg me specialiste në këtë fushë.</i></p> <p>[Evidenca 10 - Studimi i Tregut të Punës UT 2018] [Evidenca 11 - Studimi i Tregut të Punës Janar 2022]</p>								
<p>Kriteri 3. Objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Qëllimi i programit, është të sigurojë përgatitjen e specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, bazuar në programet më të përparuara të kohës. Programi u jep studentëve koncepte themelore të komunikimit dhe transmetimit të informacionit dhe përmes njohjes së veçorive kryesore të përpunimit të sistemeve të informacionit, si në harduer, ashtu edhe në softuer. Në veçanti, synohen njohuritë që mbulojnë bazat e arkitekturës së kompjuterëve dhe sistemeve kompjuterike, çështje që lidhen me projektin dhe integrimin e pajisjeve kompjuterike dhe softuerëve, me njohuri të thelluara të sistemeve operative, gjuhëve programuese, teknikave dhe metodave të inxhinierisë softuerike, parimet dhe teknologji për modelim, modelim dhe menaxhim të bazës së të dhënave etj. Përmbajtja e programit të studimit i përmbahet kërkesave të kohës dhe të tregut në vend dhe rajonit.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]; [Evidenca 11 - Studimi i Tregut të Punës Janar 2022]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="560 1718 759 1816">Niveli</th> <th data-bbox="764 1718 963 1816">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="968 1718 1168 1816">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1173 1718 1366 1816">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="560 1823 759 1865"></td> <td data-bbox="764 1823 963 1865"></td> <td data-bbox="968 1823 1168 1865"></td> <td data-bbox="1173 1823 1366 1865" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UT/FSHN ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, i cili ka 8(tetë) departamente dhe 1 (një) qendër kërkimore shkencore :</p> <ol style="list-style-type: none">1. Departamenti i Informatikës;2. Departamenti i Matematikës;3. Departamenti i Matematikës së Aplikuar;4. Departamenti i Fizikës;5. Departamenti i Kimisë;6. Departamenti i Kimisë Industriale;7. Departamenti i Biologjisë;8. Departamenti i Bioteknologjisë;9. QKFF (Qendra Kombëtare e Studimit të Florës dhe Faunës Shqiptare); <p>Burimet njerëzore: Stafi akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Informatikës dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Shkencave të Natyrës.</p> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të Teknologjisë së Informacionit; Inxhinierisë Informatike; Matematike dhe Ekonomike. Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (171 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë: <i>(Të dhëna të përpunuara nga gjetjet në DVV, viti akademik 2021-2022):</i></p> <ul style="list-style-type: none">- 31 Prof. Dr;- 39 Prof. Assoc;- 73 Dr/PhD;- 7 Dr.proc;- 21 Msc; <p>Personeli Akademik me kohë të pjesshme me kontrate (PAK) në nivel fakulteti (125 pedagogë PAE), gjithashtu ka edhe 47 personel akademik ndihmësakademik.</p>

Në Departamentin e Informatikës DI, i cili është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 29 pedagogë PAE dhe 38 pedagogë PAK (Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	Numri
Prof. Dr	-
Prof. Asoc.	3
Dr/PhD	11
Dr.proc	7
Msc	8
Total	29

Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ai ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë.

Burimet Infrastrukturore: Auditorë, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Zyra për stafin, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj..

Shërbime IT: (Shërbime Mësimdhënie Edu4school, Google Services, Go toMeeting, Google classroom, MS Teams etj)
[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Njësi kryesore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ofron programe studimi në fushën e Informatikës dhe “Teknologjisë së informacionit dhe Komunikimit” që prej vitit 2010-2011. Drejtimet kërkimore shkencore përgjatë viteve akademike 2018-2021 të Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë kryesisht, programet e studimit në shkencat e natyrës, Departamenti i Informatikës ofron dy programe studimi në Ciklin e parë Bachelor: Informatikë dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimit”, i ofruar nga Departamenti i Informatikës ka si fushë të përgjithshme fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe fushë specifike Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Teknologjia e Informacionit dhe Inovacionit. GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Informatikës është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

FSHN-së i mungon një rregullore Fakulteti, megjithëse është detyrim i sanksionuar në nenin 12, pika 6, të Statutit të UT, sipas të cilit, veprimtaria e fakultetit mbështetet ndërmjet të tjerash edhe në rregulloren e fakultetit. Nga takimi me Dekanin

	<p>dhe Zv. Dekanin për Shkencën të FSHN mësuam se ajo është duke u përgatitur.</p> <p><i>GvJ sugjeron, se FSHN/UT duhet të miratojë rregulloren e njësisë kryesore FSHN për mbarvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit të arsimit të lartë, 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe statutit të UT.</i></p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>
--	--

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimit” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të njësisë bazë “Departamenti i Informatikës”. Programi i studimit Bsc në TIK ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe nën disiplinat mbështetëse, të formojnë specialistë me kompetenca të zgjeruara praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike si dhe specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik apo privat.</p> <p>Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar RVB-së dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi nuk është përcaktuar akoma nga institucioni, kjo duke parë edhe datën e miratimit të VKM përkatëse. Megjithatë, nga analiza e programeve të lëndëve, ato janë në përputhje me objektivat e këtij programi studimi dhe të ngjashme me ato të institucioneve të tjera kombëtare që ofrojnë programe studimi analoge.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Informatikës menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokoli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënies me jashtë etj.) dhe departamentet e tjera në Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Universitetin të Tiranës që rrit efektivitetin e këtij programi studimi.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i intershipeve mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione, por në këtë program studimi nuk është zhvilluar ndonjë praktike profesionale e organizuar institucionalisht nga ana e studenteve, për sa kohe që edhe lënda e praktikës mungon në këtë program studimi në këto vite akademike të analizuara. Me anë të këtyre bashkëpunimeve UT/FSH dhe DI synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Ndër institucionet bashkëpunuese me UT/FSH/DI, 20 kompani dhe institucione në funksion të programit të studimit Bachelor TIK dhe 34 kompani institucione publike dhe private në ndihme të të gjitha programeve të studimit që FSHN mbulon.</p> <p><i>Rekomandohet që marrëveshjet institucionale të shfrytëzohen në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale, të institucionalizuar dhe ti shërbejnë studentëve të këtij programi studimi me qëllim afrimin e tyre fushat dhe tregun e punës.</i></p> <p>[Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dosjen DVV rezulton se DI ka paraqitur një dokument përmbledhës për tre vitet e fundit akademike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit të cilat mbulon. Në këtë</p>

<p>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>raport përshkruhen përfitimet në funksion të realizimit të programeve Bachelor të ofruara nga Departamenti i Informatikës nga marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe aktivitetet të tjera të zhvilluara gjatë viteve 2018-2021, kryesisht raporti ka paraqitur përfitimet e përfituara nga ana stafit akademik, i cili ka realizuar një numër mobilitetesh në kuadër të këtyre marrëveshjeve, ka patur edhe dy vizita të një profesori të Universitetit West Attica Greqi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh edhe me konferencën që DI mbante çdo dy vite, Konferenca ndërkombëtare <i>Recent Trends and Applications in Computer Science and Information Technology</i> (RTA-CSIT) ka sjellë shumë përfitime në funksion të realizimit të programit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” dhe programeve të tjera të studimit në këtë departament duke rritur bashkëpunimin me profesorë të huaj dhe duke nxitur edhe studentët të marrin pjesë në te. [Evidenca 27 – Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në planin mësimor në tre vitet e fundit akademike 2018-2021 nuk është parashikuar të zhvillohet ndonjë lende apo modul praktike profesionale. Bazuar në RVB, DI ka shprehur se lënda praktike profesionale është futur në vitin akademik 2022-2023, por që nuk është paraqitur në DVV apo në tabelat përkatëse si ndryshim në planin mësimor të programit të studimit. Njësia kryesore FSHN dhe njësia bazë DI kane lidhur një numër marrëveshjesh për realizimin e bashkëpunimeve, por për këtë program studimi nuk evidentohen që studentët të kenë kryer praktika profesionale.</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të bëjë përpjekje për fuqizimin e bashkëpunimeve me aktor të ndryshëm të fushës së TI dhe sa më shpejtë të përfshijë në planin mësimor për të gjithë studentët aktual, lëndën e praktikës profesionale.</i></p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit;]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në DVV, RVB dhe evidentimin përgjatë vizitës në institucion rezulton se DI zhvillon çdo dy vite konferencën shkencore RTA-CSIT, në këtë konference ftohen të marrin pjesë studente dhe të diplomuar për të shkëmbyer idetë e tyre në lidhje me fushën e TI. DI gjithashtu zhvillon në mënyrë të përvitshme edhe programin “<i>Young Programmers Space</i>” i cili synon të rrisë iniciativën e programuesve të rinj dhe kualifikimin e mëtejshëm për studentët dhe të diplomuarit. DI rezulton se ka zhvilluar edhe dy leksione të hapura duke ftuar</p>

	një profesor nga universiteti West Attica si dhe një workshop në bashkëpunim me kompaninë Mozenda. [Evidenca 29 – Aktivitete Departamenti Informatikës 2018 – 2021 [https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/young-programmers-space]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019]; [Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë	Programi mësimor i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është hartuar në përputhje me

<p>synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" i korrespondon Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialist në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; • Specialist në IT në institucione publike dhe private; • Programues software; • Specialist rrjetash kompjuterike; • Menaxher projektsh IT; • Menaxher i sistemeve të informacionit; <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 10 - Studimi i Tregut të Punës UT 2018]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve me një bagazh të gjerë, të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit më të specializuar. Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të UT-së, Departamenti i Informatikës synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve. Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi. [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ndër objektivat formuese të programit të Ciklit të Parë të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", është t'u japë studentëve njohuritë bazë dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, mbështetur në këndvështrimin e thellimit të njohurive në ciklet e larta të studimit duke patur edhe si qëllim kërkimin shkencor në të ardhmen. Ndër të tjera programi synon që studentët të jenë në gjendje të programojnë, të projektojnë zgjidhje të problematikave në fushën e teknologjisë së informacionit duke shfrytëzuar analiza të aplikuara, bazuar në kërkesat e</p>

	<p>përdoruesve për sisteme të tilla IT. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në dokumentacionin e dorëzuar.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]; [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit, Syllabuset].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënës, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, më poshtë:</p> <p>A. LËNDË BAZË-30 kredite ose 16,7%; B. LËNDË KARAKTERIZUESE-94 kredite ose 52.5%; C. LËNDË NDËRDISIPLINORE -25 kredite ose 13.9%; D. LËNDË PLOTËSUESE -21 kredite ose 11,7%; E. DETYRIME PËRMBYLLËSE-10 kredite ose 5.5%;</p> <p>Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, kryesisht leksione dhe seminare. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se pothuajse të gjitha seminarët dhe leksionet zhvillohen në laboratorë ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në kompjuter.</p> <p><i>Megjithëse lënda e praktikës mësimore është parashikuar të shtohet në planin mësimor duke filluar nga viti akademik 2022-2023, GVJ rekomandon që kjo lende të përfshihet edhe për studente të cilët janë aktualisht të lidhur me planet e mëparshme mësimore.</i></p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>

	[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni UT-ës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës si njësi kryesore është i organizuar në 9 njësi bazë të cilat plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi për sa i përket numrit të stafit akademik dhe kriterëve të kualifikimit shkencor të tij. Departamenti i Informatikës si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit plotëson kriteret ligjore dhe ka një staf akademik të ri, por të kualifikuar dhe me eksperience në fushën e Informatikës dhe të Teknologjisë së Informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” është hapur me VKM Nr. 568, datë 14.07.2010. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p>[Evidenca 57 – Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018]</p> <p>[Evidenca 30 – Organigrama e FSHN]</p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT-se, Rregulloret e brendshme të institucionit, rregulloren e programit të studimit, përgjegjës për programin e studimit është njësi bazë, Departamenti i Informatikës. Në rregulloren e programit të studimit është e shprehur qarte që përgjegjësi departamentit DI është përgjegjës për ecurinë e programit të studimit, ai cakton koordinatort për programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe takimin me studentët u evidentua që departamenti DI kish caktuar koordinatort (kujdestar), me detyra të përcaktuara qarte për</p>

<p>Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>evidentimin dhe raportimin e problematikave të mundshme përgjatë ecurisë së procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës];</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>																																					
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës në vitin akademik 2021-2022 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (171 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Të dhëna të përpunuara nga gjetjet në DVV, viti akademik 2021-2022)</p> <table border="1" data-bbox="574 627 1356 1041"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>Nr. personel PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>31</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>39</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>73</td> </tr> <tr> <td>Dr. Proces</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>171</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli Akademik me kohë të pjesshme me kontrate (PAK) në nivel fakulteti (125 pedagogë PAE), gjithashtu ka edhe 47 personel akademik ndihmës akademik.</p> <p>Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezultojnë se çdo njësi bazë e FSHN plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.</p> <p>Departamenti i Informatikës si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informatike dhe Komunikimi në vitin akademik 2020-2021 ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="574 1467 1356 1948"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Informatikës</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>11</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr në proc</td> <td>7</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>8</td> <td>34</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>29</td> <td>38</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi	Nr. personel PAE	Prof. Dr.	31	Prof. Asoc.	39	Dr./PhD	73	Dr. Proces	7	Msc.	21	Gjithsej	171	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Informatikës		PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	Prof.Asoc	3	1	Dr/PhD	11	3	Dr në proc	7	-	Msc	8	34	Gjithsej	29	38
Kualifikimi	Nr. personel PAE																																					
Prof. Dr.	31																																					
Prof. Asoc.	39																																					
Dr./PhD	73																																					
Dr. Proces	7																																					
Msc.	21																																					
Gjithsej	171																																					
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Informatikës																																					
	PAE	PAK																																				
Prof.Dr	-	-																																				
Prof.Asoc	3	1																																				
Dr/PhD	11	3																																				
Dr në proc	7	-																																				
Msc	8	34																																				
Gjithsej	29	38																																				

	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës në katër vitet e fundit akademike, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021 dhe 2021-2022 plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili përbëhet nga 8 njësi bazë plus 1 qendër kërkimore shkencore.</p> <p>Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>[Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK] [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3														
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.														
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve													
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren e programit mësimor, Syllabuset, orarin, Ngarkesën e stafit akademik etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Shënime gjate vizitës, Orari mësimor]</p>													
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë (programi mësimor 2018-2021:</p> <table border="1" data-bbox="542 1702 1356 1926"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi Bsc. TIK</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>15%-20%</td> <td>30</td> <td>16.7%</td> </tr> </tbody> </table>				Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Bsc. TIK		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	15%-20%	30	16.7%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Bsc. TIK												
		Kredite	Përqindje											
A. LËNDË BAZË	15%-20%	30	16.7%											

B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 55%	94	52.2%
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-15%	25	13.9%
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%-15%	21	11.7%
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%- 5%	10	5.5%

Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban: 31 lëndë plus provimin përfundimtar.

Në syllabuset e lëndëve paraqiten aktivitetet didaktike si leksion dhe seminar, *por nuk paraqiten kreditet dhe orët për laboratorët*. Gjatë vizitës në institucion, u qartësua, se në veprimtarinë mësimore të quajtur ‘seminar’, përfshihen edhe ushtrimet edhe laboratorët në një kategori të vetme.

Ndarja e krediteve në mënyrë të detajuar për të gjitha aktivitetet didaktike të parashikuara (Leksione, Seminare/Ushtime, Laboratore, detyra/projekt kursi, etj.) ndihmon institucionin në monitorimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë.

Një ndarje e qartë e orëve dhe krediteve për aktivitetet formuese, i lejon institucionit të monitorojë dhe të ketë instrumente sasiore vlerësues për nevojën për infrastrukturë në mbështetje të programit të studimit. Pra përcaktimi i krediteve për aktivitetet laboratorike, dhe orëve përkatëse, i mundësojnë institucionit të vlerësojë në mënyrë sasiore oraret dhe mjaftueshmërinë e ambienteve laboratorike dhe kapacitetet maksimale që ato kanë për tu shfrytëzuar. Ndarja e aktiviteteve dhe orëve përkatëse, i shërben edhe monitorimit të jashtëm të cilësisë, në formë sasiore për zhvillimin e të gjitha formave të mësimdhënies të parashikuara në planin mësimor.

Rekomandohet që plani mësimor të qartësohet, duke ndarë në kredite dhe orë përkatëse të gjitha aktivitetet didaktike si leksione, seminare/ushtime, laborator, detyra/projekte kursi, etj.

[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]

[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]

Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në gjashtë semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” rezulton me 30

<p>evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe tre vite akademike.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve, jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminareve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi / ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe jepet në sulabusin përkatës të çdo lëndë.</p> <p>Vlerësimi i dijeve gjatë vitit është i specifikuar për secilën lëndë, vlerësimi ndryshon ndërmjet lëndëve të ndryshme si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 0-10% niveli i diskutimit në seminare; - 0-30% detyrë kursi; - 0-100% provimi i ndërmjetëm; - 0-100% provimi përfundimtar; <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur se prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme për seminarët në masën 75%, laboratorët dhe detyrat e kursit në masën 100%:</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Njësia bazë departamenti DI propozon kuotat të cilat miratohen konform rregullores dhe statutit të UPT në instancat me të larta. Kriteret e pranimit dhe të transferimit të studimeve, njohjes se krediteve janë përcaktuar dhe publikuar në faqen zyrtare të FSHN.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[https://fshn.edu.al/info/rregullore]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, ato integrojnë elementët në vijim:</p>

<p>nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e lëndës; • Ngarkesën e lëndës në kredite; • Semestrin kur zhvillohet lënda; • Përshkrimin dhe objektivat e lëndës; • Rezultatet dhe kompetencat e mësimit; • Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; • Detyrimet e lëndës; • Literaturën bazë; • Literaturën ndihmëse; • Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; • Përmbajtjen e temave të kursit; <p>Në disa plan-programe, nuk ishin përcaktuar literatura e detyrueshme apo edhe ndarja e orëve në auditor me ato për studimi individual.</p> <p><i>Rekomandojmë që institucioni të rishikojë syllabuset e lëndëve për të qenë të gjitha të uniofmuara dhe me informacion të plotë.</i></p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021] [VKM Nr.879, date 18.12.2019]</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Sipas RVB, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="528 1541 743 1644">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="743 1541 956 1644">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="956 1541 1161 1644">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1161 1541 1375 1644">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.4
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të

Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total. Konstatohet se ky organizim është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndarja e orëve mësimore është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="560 461 1358 875"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="3">Mësim në auditor dhe punë e pavarur</th> <th rowspan="2">Total orë / (120 ECTS)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>Studim individual</th> <th>Praktika profesionale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti I</td> <td>645</td> <td>855</td> <td>-</td> <td>1500</td> </tr> <tr> <td>Viti II</td> <td>630</td> <td>870</td> <td>-</td> <td>1500</td> </tr> <tr> <td>Viti III</td> <td>670</td> <td>830</td> <td>-</td> <td>1500</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>1945</td> <td>2555</td> <td>-</td> <td>4500</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]</p>	Viti akademik	Mësim në auditor dhe punë e pavarur			Total orë / (120 ECTS)	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale	Viti I	645	855	-	1500	Viti II	630	870	-	1500	Viti III	670	830	-	1500	Total	1945	2555	-	4500
Viti akademik	Mësim në auditor dhe punë e pavarur			Total orë / (120 ECTS)																									
	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale																										
Viti I	645	855	-	1500																									
Viti II	630	870	-	1500																									
Viti III	670	830	-	1500																									
Total	1945	2555	-	4500																									
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Një pjesë e lëndëve karakterizuese zhvilloheshin në laborator duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës.. Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes këtij procesi për të mundësuar angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal të dijeve nga ana e tyre. Zhvillimi i praktikës profesionale (të munguar) pranë kompanive apo institucioneve do të sillte me tepër përfitimi për studentët dhe do të ishte një mundësi për t’u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të iniciuar punësimin e tyre të ardhshëm.</p>																												
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” janë vlerësuar shumë pozitivisht në disa projekte që kanë marrë pjesë dhe kjo është përdorur si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar. [Evidenca 24 – Raporti Vjetor i Departamentit të Informatikës 2021 – 2022]</p>																												

<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Seminare. Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike Në këtë program studimi nuk ka një shpërndarje të krediteve në aktivitetet formuese, DI dhe institucioni kane bere një shpërndarje të orëve ndërmjet aktiviteteve formuese. Nëse do t'i referoheshim orëve të planifikuar në auditor për këto aktivitete formuese rezulton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 830 Orë në auditor; • Seminare / 803 Orë në auditor ; • Detyra/Projekte/ Laboratorë 237 Orë në auditor; • Praktikë 25 Orë në auditor; • Provim formimi 50 Orë në auditor; <p>Raporti Teori (leksion) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt profes.) rezulton 830 ore/1065 ore, ose afërsisht 1:1 ose 44% :56%, GVJ gjykon që ky raport është në përputhje me profilin e programit e studimit të ciklit Bachelor.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK] [Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Gjatë takimit më personelin akademik dhe me studentët evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Pra, orët në auditor për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj.) janë më të larta se për përgatitjen teorike (orët e leksioneve). GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e parë të studimeve.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK] [Shënime në vizitë_5_6 Korrik UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GVJ konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit, ose dispenca e reja të vetë pedagogëve. Disa nga literaturat në</p>

<p>bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>syllabuse nuk janë të 5 viteve të fundit. Hapat tepër të shpejtë të zhvillimit të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit e bëjnë shumë të vështirë krijimin e literaturave përkatëse.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton, bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli Bachelor. Disa nga lëndët që përfshihen në këtë program dhe që garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi Specialist dhe ekspert në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; Menaxher projektsh; Menaxher i sistemeve të informacionit; Kërkues shkencor në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit) janë: Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; Hartim Dhe Menaxhim Projektsh Në Teknologji Informacioni; Menaxhim strategjik i teknologjisë dhe Inovacionit; Metoda Kërkimi të Avancuara në Teknologji Informacioni. etj. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK] [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” u jep mundësi studentëve të pozicionohen qartësisht në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021] [Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat</p>	<p>Departamenti i Informatikës në saje punës shume vjeçare ka vendosur ura komunikimi të përhershme me aktore të biznesit në fushën e TI-së, në mënyre të përvitshme ai organizon takime ku diskuton për fushat dhe projektet ku mund të bashkëpunojnë, gjithashtu një vëmendje ky departament i kushton edhe</p>

<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>përmirësimet të programeve të studimit. Di gjithashtu ka kontakte edhe me disa universitete në Itali, Spanjë dhe Gjermani, nga të cilët ka marrë edhe modelet e programeve të studimit. Gjithashtu UT se bashku me FSHN organizon në mënyrë të përvitshme ditët e karrierës ku studentët kanë mundësi të takojnë aktorët e biznesit e cila shikon një mundësi shume e mire për punësimin e tyre. Duke analizuar programin e studimit përmbajtja e tij synon të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë e kërkesat e tregut e punës. Në dokumentin e dorëzuar nga institucioni për punësimin real të studentëve jepen të dhëna për 478 studentë të diplomuar në vitet 2017-2021 nga të cilët 87 % studentë të anketuar (8% e studenteve të diplomuar) janë të punësuar në përputhje me diplomën. [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.5</p>																																																						
<p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>																																																						
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>																																																					
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="571 1346 1353 1832"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>8</td> <td>2</td> <td>9</td> <td>3</td> <td>9</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>11</td> <td>13</td> <td>11</td> <td>11</td> <td>9</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>19</td> <td>16</td> <td>20</td> <td>16</td> <td>18</td> <td>16</td> </tr> </tbody> </table> <p>Titullarët të moduleve mësimore në programin Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” mbulohen nga</p>						Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	1	-	1	-	1	Prof. Asoc.	-	-	-	1	-	1	Dr/Phd	8	2	9	3	9	3	Msc.	11	13	11	11	9	11	Gjithsej	19	16	20	16	18	16
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																
Prof. Dr	-	1	-	1	-	1																																																
Prof. Asoc.	-	-	-	1	-	1																																																
Dr/Phd	8	2	9	3	9	3																																																
Msc.	11	13	11	11	9	11																																																
Gjithsej	19	16	20	16	18	16																																																

pedagogë të cilët kanë gradë shkencore. Bazuar në dokumentacion DVV stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitin 2021-2022 ka kualifikimin si më poshtë:

- 1 pedagog me titullin Prof. Dr.
- 1 pedagog me titullin Prof. Asoc.
- 12 pedagogë me gradën shkencore Dr.
- 20 pedagogë me gradën shkencore Msc.

I gjithë stafi i angazhuar në mësimdhënie është me grada e tituj.
Pika 6 e nenit 59 të ligjit 80/2015 përmbushet.

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton një qëndrueshmëri në stafin akademik ndër vite, çka është pozitive në kuadër të cilësisë së mësimdhënies.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore (ref. Tabelave 12), u konstatua se për tre vitet akademike mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2018-2019	3942	2795	1147	71% / 29%
2019-2020	3282	2262	1020	69% / 31%
2020-2021	2470	1745	725	71% / 29%

Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet **kryesisht.**

[Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Bazuar në CV e stafit akademik, niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikimet e moduleve të tij. Lektorët punojnë në fushat e kërkimit që përputhen me konceptet e mësuara në programin e studimit bachelor dhe ato përfshijnë elemente të fushës të tyre të kërkimit në lëndë. [CV Emër Mbiemër]

<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se rezultojnë, Universiteti i Tiranës dhe FSHN ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. DI vërtet ka vendosur ura bashkëpunimi me këto institucione, por mungesa e një lëndë në planin mësimor të dedikuar praktikës mësimore ka sjell në mungesën e një mundësie për studentët për të realizuar praktike të mirëfilltë profesionale pranë sisteme reale të TI. Nga ana tjetër DI është mjaftuar me realizimin dhe ndjekjen e detyrave dhe laboratorëve pranë institucionit. Vete institucioni përpiqet që nëpërmjet Zyrës së karrierës dhe Degës së Zyrës së karrierës dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të asistoj dhe ndihmojë studentët në gjetjen e mundësive për zhvillimin e karrierës, shembull në këtë rast është zhvillimi i leksioneve të hapura se si të behësh programues i suksesshëm .</p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 25 – Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016 – 2021]</p>
---	--

<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e FSHN (klasat /laboratorët ku bëhet mësim nga studentet e këtij programi) GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhej nga IT Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se pedagogët e lëndës realizojnë dhe anën praktike të saj (laboratorët). Nga shqyrtimi i CV-ve stafi akademik është i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime ne vizite 5_6 Korrik FSHN/UT] [CV Emër Mbiemër].</p>
--	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Faqe 29




Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. Universiteti UT/FSHN përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur evidencën në mësimdhënie dhe mësimnxënie. UT/FSHN mbështet dhe vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie. DI si njësi bazë kryesore në FSHN për zbatimin e metodave të reja në mësimdhënie ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme (manual për përdorimin e platformës MS Teams; Hyflex) në mësim dhënie inovative.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të Universitetit të Tiranës është “Cilësia dhe performanca Akademike”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Bazuar në DVV dhe informacioni përgjatë vizitës në FSHN konstatohet se njësi përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies se personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësi bazë DI. Drejtuesi i njësisë bazë DI analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtari të DI dhe me pas kontakton çdo anëtar për të shprehur gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Nga ana tjetër UT ka zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, kështu janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 63 – Formulari i vlerësimit të lëndës nga studenti, viti akademik 2020 -2021]</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë dy herë në vit dy javë përpara përfundimit të çdo semestri. Formati i pyetësorit është i organizuar në tre sesione: pedagog; lënda dhe stafi administrativ. Anketimet përpunohen në mënyre manuale, rezultatet u bëhen me dije dhe ndahen me stafin si dhe adresohen sipas përgjegjëseve dhe funksioneve për efekt përmirësimi. Gjatë periudhës së pandemisë është zhvilluar një pyetësor online ku studentët kanë shprehur mendimet e tyre në lidhje me mësimin online. NJBSC shprehet se kur ka pasur ankime ato janë trajtuar.</p> <p>[Evidenca 36 – Paketa e Instrumenteve të Cilësisë]</p> <p>[Evidenca 39 – Raporti mbi sondazhin e mësimin online]</p> <p>[Evidenca 92 – Raporti i Vlerësimit të Lëndëve Semestri I 20-21]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në Universitetin e Tiranës . Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe NJSBC. Ata vlerësojnë performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit, që plotësohet në përfundim të çdo semestri.</p> <p>NJBSC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të Universitetit të Tiranës . Ky raport i shkon gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë dhe Dekanit të FSHN, i cili vë në dijeni të vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë konfidenciale personelin akademik. NJBSC gjithashtu harton një raport në nivel institucioni.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p> <p>[Evidenca 35 – Raporti Vjetor DSBC 2020 – 2021]</p> <p>[Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumenteve konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet</p>

mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>trajtimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. UT është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjesë në programe shkëmbimi siç janë Erasmus+ KA1 dhe KA2, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 35 – Raporti Vjetor DSBCCK 2020 – 2021] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT] [Evidenca 49 – Lista e mobiliteteve të stafit të DI 2018 – 2022] [Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitë në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabuset e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e Miratuar të programit.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]</p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga Universiteti i Tiranës .</p> <p>Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënies sa më të mirë. Një mënyre alternative ka qenë edhe mësimi</p>

<p>përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>online i diktuar edhe nga kushtet e pandemisë, për të cilën personeli akademik ka qenë i mirë përgatitur dhe ka përdorur metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit të lëndëve. Disa nga metodat e përdoruar gjatë mësimdhënies janë: simulimi, video, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer detyra të pavarura etj.</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime ne vizite_5_6 Korrik UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai ka hartuar një udhëzues për këtë qëllim dhe zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike.</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p> <p>[Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p> <p>[CV Emër Mbiemër]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion FSHN, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies be mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vene në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndëve në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative të përdorur nga DI dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. Gjatë vizitës në FSHN, në takimin me studentët pjesëmarrës nga viti I,II,III i programit të studimit mësuam se ishin të kënaqur nga</p>

	<p>infrastruktura e vënë në dispozicion nga FSHN dhe metodat e përdorura në mësimdhënie nga personeli akademik në sistemin online. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies. Studentët konfirmuan plotësimin e pyetësorëve në sistemin online dhe atë të shkruar në letër në formë anonime. [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion. takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Përdorimi i sistemit online të mësimdhënies e ka bërë të domosdoshme përdorimin e teknikave dhe metodave interaktive me qëllim rritjen e fokusit dhe interesit të studentëve, me anë të aktivizimit e të gjithë studenteve në pune praktike, projekte, përfshirjen në punën në grup dhe projekte nën udhëheqjen e personelit akademike fushës. Përdorimi i infrastrukturës inovative në mësimdhënie të vënë në dispozicion nga FSHN dhe demonstrimet në laborator e kanë rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik është inkurajuar nga UT/FSHN të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor. Gjithashtu pedagogët e departamentit DI përpiqen që me anë të leksioneve të hapura të zhvilluara në mënyrë të përvitshme të ndihmojnë studentët dhe të diplomuarit në zhvillimin e karrierës së tyre si programues dhe menaxhues të projekteve të IT-së.</p> <p>[Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu] [Evidenca 65 – Leksion i hapur “Bëhu një programues i suksesshëm”]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të bollshme dhe mirëmbahen rregullisht. Godinat janë të pajisura me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditorë. Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të të gjithë aktiviteteve didaktike.</p> <p>[Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN] [Evidenca 47 – Detajet e infrastrukturës së DI]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ nga vizita në vend në UT/FSHN konstaton se ambientet e dedikuara për procesin mësimor në godinë, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe me internet (wireless). [Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët e FSHN/DI përdorin sisteme IT të zhvilluara apo të përshtatura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Microsoft Teams, që mund të përdoret për të publikuar materialin mësimor, në lidhje me lëndët përkatëse, për të komunikuar pedagogët me studentët etj; – e-Student sistem i brendshëm i shkëmbimit të informacioni i cili shërben punonjësve të UT si dhe studenteve; – “Sistemi i Vlerësimit online i pedagogëve” i cili vjen në ndihmë NJBSC për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve nga studentët; – “FSHN -SharePoint”, i shërben UT/FSHN për menaxhimin e dokumentacionit, një arkivë digjitale në të cilën gjenden të gjitha informacionet e FSHN/DI; <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT] [Evidenca 75 - e-Student UT Manual përdorimi – Pedagogët] [Evidenca 76 - Sistemi e-Student Manual përdorimi]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në</p>	<p>Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet procesi mësimor në programin Bachelor në</p>

<p>dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën teknologjisë së informacionit. Duke qenë se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” formon specialistë në një fushë që zhvillohet me hapa shumë të shpejtë ka vështirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën shqipe, literatura për lëndët karakterizuese të këtij programi studimi të përdorur është kryesisht në gjuhë të huaj, për lëndët bazë ka literature në gjuhën shqipe, nuk mungojnë edhe dispensat e realizuara nga stafi akademik. Literatura është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike, gjithashtu ofrohen në mbështetje të programit të studimit edhe burime të tjera elektronike të informacionit, të cilën FSHN e ofron në lidhje direkt prej faqes web në burimet Edward Elgar Journals, IOP, MSP dhe Cobiss</p> <p>[Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e programit të studimit kryesisht ruhet fizikisht në bibliotekë. Biblioteka pasurohet në fillim të çdo viti akademik. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt, që mund të shtohen në bibliotekë. Biblioteka e FSHN ka një ambient të bollshëm i pajisur me vende studimi dhe me kushte të përshtatshme studimi, sigurohet internet në të gjitha ambientet. Departamenti i Informatikës, si pjesë e Universitetit të Tiranës në bashkëpunim me AADF ka akses për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR. JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. Falë marrëveshjes së finalizuar, biblioteka digjitale JSTOR u jep mundësi stafit akademik të FSHN dhe studentëve të hulumtojnë në shumë fusha studimore, përfshirë atë të Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Stafi akademik i Departamentit dhe studentët kanë akses në U-Library (https://ulibrary.rash.al/), biblioteka digjitale, që u ofrohet universiteteve publike nga MASR nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar. Gjithashtu, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka abonime në disa periodikë si : ASTM International, ASTM Compass abstract; Edward Elgar Journals; IOP Science; MSP Journals.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përiferëta me programin e studimit.</p>	<p>[Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p> <p>[Evidenca 52 – Rregullore Bibliotekës FSHN]</p>

	[Evidenca 73 – Manuali i përdorimit e librarisë digjitale]
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Studentët e programit të ciklit të Parë të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ” mund të përdorin 6 laboratorë për realizimin e laboratorëve të parashikuara për lëndët përkatëse të këtij programi studimi, për projekte apo për t’u përgatitur për provimet ndërmjetëse dhe provimit përfundimtar. Laboratorët kryesisht janë të pajisur me kompjuter desktop ose laptop me parametra optimal për zhvillimin normal të punëve dhe detyrave përkatëse. Në funksion të studente në rast të kërkesave të tyre është edhe qendra data-center e përberë nga disa servera ku ata mund të ruajnë simulime apo detyra përkatëse.</p> <p>[Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e DI]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët në Universitetin i Tiranës përdorin platformat Microsoft Teams dhe e-Studenti. Kjo platformë është konfiguruar dhe përshtatur në vitin akademik 2018-2019 dhe është shfrytëzuar dhe gjate viteve akademik 2019-2020/2020-2021.</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p> <p>[Evidenca 74 - Microsoft-office-365-për-student]</p>
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	<p>Universiteti i Tiranës ka vënë në dispozicion llogari Office 365 për personelin akademik dhe studentët. Office 365 i ofron studentëve dhe personelit akademik hapësirë vetjake të dedikuar në të cilën mund të ruhet dokumentacioni elektronik si dhe mundësinë e komunikimit elektronik nëpërmjet postës elektronike. “UT Tiranës -SharePoint”, i shërben gjithashtu UT për menaxhimin e dokumentacionit. Gjithashtu DI ka ndërtuar edhe sistemin e-Student i cili shërben për komunikimin e brendshëm dhe menaxhimin e informacionit.</p> <p>[Evidenca 74 - Microsoft-office-365-për-student]</p> <p>[Evidenca 75 - e-Student UT Manual përdorimi]</p>
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Bazuar në rregulloren e UT, përmbyllja e studimeve realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Për hartimin e programit të provimit përfundimtar DI ngre një grup pune Ad-hoc i cili miratohet nga Dekani i FSHN. Stafi akademik i angazhuar programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” mbështet studentët në fushat përkatëse sipas nevojës së studenteve.</p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p>


	[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]			
	[Evidenca 67 - Komisioni i provimit të diplomimit TIK]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës në statutin e tij ka përcaktuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. KPSSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës”, në dy aspekte kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit; 2. Vlerësimin e Brendshëm Institucional; <p>Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe në rregulloret e sigurimit të cilësisë së secilës njësi kryesore. KPSSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve dhe me Degën e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN, për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të KPSSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 138]</p> <p>[Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë]</p> <p>[Evidenca 35 – Raporti Vjetor DSBCK 2020 – 2021]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Informatikës është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e vete universitetit. Duke pasur parasysh që kërkesat për cilësi janë gjithmonë në rritje dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhornime të</p>

	<p>vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat kombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marre pjese në leksionet e mbajtur nga aplikantët.</p> <p>Departamenti bën analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme. Bazuar në raportimet e vlerësimit të cilësisë dhe udhëzuesit strategjik të metodave inovative hartohen dhe zbatohen module trajnimi.</p> <p>[Evidenca 46 – Procedurë punësimi personel akademik efektiv]</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka një udhëzues strategjik për periudhën 2018-2023 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë strategji DI luan një rol kryesor duke kontribuar në ndërtimin e platformave të reja mësimdhënie. Për shkak edhe të pandemisë, në vitet akademik 2019-2020 (sem II), 2020-2021 u realizua sistemi online i mësimdhënies fale edhe mbështetjes së madhe të stafit të DI dhe specialisteve të IT të UT-së. UT në funksion të cilësisë së programit të studimit ka miratuar “Qendrën virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit”.</p> <p>[Evidenca 4 - Strategjia E Zhvillimit Të UT 2018-2023]</p> <p>[Evidenca 79 – Thirrje për projekte në programin “UT kërkim ekselencë dhe inovacion”]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Për këtë qëllim, personeli akademik ai mbështetës dhe administrativ, mbështetet financiarisht në pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare të zhvilluara këto në Shqipëri dhe jashtë saj. Personeli akademik i DI/FSHN megjithëse në një moshë relativisht të re është në masën më të madhe i kualifikuar me gradën shkencore Doktor, ai është përberë nga specialistet më të mirë të gjuhëve të programimit dhe sistemeve të TI-së. Nga ana tjetër edhe personeli akademik i FSHN-së në funksion të promovimit të tij, si dhe të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe kërkimor të institucionit, në fillim të çdo viti akademik paraqet në departament planin e veprimtarisë së tij kërkimore. Plani i aktivitetit kërkimor i mbështetur në pajisje shtesë, paraqitje të rezultateve të kërkimit në konferenca dhe revista kombëtare</p>



	<p>dhe ndërkombëtare reflektohet dhe në planifikimin e buxhetit të Departamentit. Njësia bazë në FSHN/DI në fund të çdo viti akademik dhe personeli akademik paraqet një raport të realizimit të planit të veprimtarisë së tij kërkimore. Mbi bazën e analizave vjetore, departamentet në FSHN bëjnë vlerësimin e punës së personelit akademik, të grupeve mësimore-kërkimore si dhe të departamentit në tërësi dhe nxjerrin rekomandimet përkatëse për orientimin me të mire të kërkimit shkencor.</p> <p>[Evidenca 26 – Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës] [Evidenca 96 - FSHN Raporti Shkencor 2018-2019]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe vizitën në institucioni rezulton se stafi akademik i FSHN dhe DI është përfshirë në mënyre të drejtpërdrejte në organizimin dhe realizimin e trajnimeve, workshope-ve dhe projekteve të ndryshme, të gjitha në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe të implementimit të metodave të reja. Në funksion edhe të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies UT ka realizuar disa marrëveshje të ndryshme në kuadër të programeve Erasmus, kështu stafi i FSHN/DI në bashkëpunim me koordinatoren lokal ka aplikuar dhe realizuar mjaft mobilitete në Universitete të ndryshme në Evropë.</p> <p>[Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021] [Evidenca 49 – Lista e mobiliteteve të stafit të DI 2018 – 2022]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i njësisë bazë, përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin përzgjedhjen e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje më të mirë nga stafi me ekspert. Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Aktiviteti vjetor i departamentit DI i cili përfshin edhe evidentimin e punës individuale të stafit, pikat e forta në programet e studimit, mangësitë e hasura përgjatë vitit dhe objektivat për vitin e ardhshëm dokumentohet në raportin vjetor të njësisë bazë. [Evidenca 24 – Raporti Vjetor i DI 2021 – 2022]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioneve dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në</p>

reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmërinë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Departamenti i Informatikës nxit dhe mbështet stafin akademik. Departamenti ka vendosur si një nga objektivat e tij strategjik “Zbatimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore”.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm të cilat janë specifike në varësi të tipit të lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 0-10% niveli i diskutimit në seminare - 0-50% detyrë kursi - 0-70% provimi i ndërmjetëm - 0-100% provimi përfundimtar <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se në çdo program studimi që DI mbulon studentët informoheshin mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve, format e kontrollit ishin të ndryshme bazuar në specifikat e secilës lëndë. Ato ishin të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informoheshin rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luajnë edhe kujdestaret e grupeve si dhe koordinatori i programit të studimit. Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i</p>

	<p>lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të cilat i bëhen të ditura studentit. I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendej lehtësisht në faqen zyrtare të FSHN-së.</p> <p>[Shënime në vizitë UT/FSHN]</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p> <p>[Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p> <p>[https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-informatikes/Programmes/teknologji-informacioni-bsc]</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [0-70%], Niveli i pjesëmarrjes në seminare [0-10%], Detyra e kursit (projekte) [0-50%] Provimit përfundimtar [0-100%]. Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit,]</p> <p>[Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6</p> <p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar në DVV, sylabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Kryesisht kontrollet dhe</p>

	<p>provimet e ndërmjetme realizoheshin pas mesit të secilit semestër. [Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi në FSHN është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (“pencil and paper”, vlerësimin me gojë) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Sipas RVB në disa lëndë është aplikuar testimi online duke përdorur Office 365, nisur edhe ka kushtet prej pandemisë. Nga takimi me studentët testimi online është realizuar në platformën Teams, me kamera hapur.</p> <p>[Evidenca 56 - Dosja e programit të studimit;] [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se FSHN/UT ka përcaktuar në rregulloren e UT se Dekani miraton komisionet e provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave dhe Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. GVJ konstaton se provimet me shkrim sekretohen nga personeli i mbikëqyrës i provimit. Në dokumentin GVB citon: <i>Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara në cilat ruhet anonimatit deri në përfundim të vlerësimit me notë.</i></p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK;]</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK;]</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e universitetit UT. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen ne rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht te punimet e diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmerisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës se pedagogut dhe Rregullores së Etikës.</p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatik në rast të zhvillimit të tyre në platformën Teams, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda 15 ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit ose verbalisht në mënyre individuale në auditorë. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p> <p>Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime ne grup ose individuale, etj.</p> <p>[Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet e drejta e studentit për animimin e rezultateve të provimit. GVJ citon nga ky dokument: [...<i>Studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda 48 orëve nga marrja dijani e vlerësimit, ankesë me shkrim tek Përgjegjësi i njësisë bazë DI përkatës me anë të së cilës kërkojnë të rishikohet vlerësimi i provimit...</i>]</p> <p>GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet përgjegjësit të departamenti i cili në rast të moszgjidhjes se problemit i drejton për zgjidhje</p>

	<p>Dekanit. Dekani brenda 48 orësh nga marrja dijëni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. [Evidenca 6 Rregullore e Universitetit të Tiranës , Neni 51]</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Rregullorja e UT, përkatësisht <i>nenet 50 dhe 51</i> kanë të përcaktuara të gjitha detajet mbi ankimin e vlerësimit. Studenti ka të drejte të ankohet për mos plotësimin e rregullave të provimit dhe të vlerësimit të tij. Kërkesa për ankimi note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UT/FSHN (referuar takimit me stafin akademik dhe studentët)</p> <p>[Evidenca 6 Rregullore e Universitetit të Tiranës , Neni 50,51]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përputhje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit te dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike dhe praktike ne fushën e teknologjisë se informacionit, IT, praktiken profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për thellimin e njohurive në studimet e mëvonshme ne ciklin e dytë master.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studentit në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtese krahas procesit mësimor, te tilla si konsultime apo leksione te hapura. Stafi akademik përfshin studentet ne veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë ne përthithjen e aftësive ne fushën e IT, gjuhëve të programimit, softwar-eve të ndryshëm etj.</p> <p>Studentet përfshihen edhe ne veprimtarinë kërkimore te stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit</p>

	<p>mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi. UT/FSHN/DI ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila do tu sigurojë kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, Fakulteti përgjegjës për programin e studimit në vlerësim, po punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Lidhur me kete kriter, referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndës/modulit paraqesin qartë ne përmbajtjen e tyre: ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse, objektivat, aftësitë dhe kompetencat qe priten të fitoje studenti. Këto elemente qe detajohen ne çdo lende janë pjese integrale e objektiveve te përgjithshme te programit. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Departamenti i Informatikës analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në: Analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektiveve formuese dhe rezultateve të pritshme të nxënit dhe aftësimit profesional në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. [Evidenca 26 – Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës]</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës, në javën përpara testit ndërmjetës dhe në javën e 15 përpara provimit përfundimtar pedagoget bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final. Pedagogët përfshijnë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera, si konferenca (seminare) të</p>

<p>të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të zgjeruara ku marrin pjesë jo vetëm studentet e programit të studimit por edhe studente dhe pedagoge nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera.</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams];[Evidenca 65 – Leksion i hapur “Bëhu një programues i suksesshëm”]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike dhe praktikat profesionale së bashku me studentët. Gjate zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit. [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër.</p> <p>Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të çdo lëndë krijojnë klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative. DI mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore te suksesshme.</p> <p>[Evidenca 71 - Detyre kursi 1] [Evidenca 72 - Detyre kursi 2] [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në FSHN aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile.</p> <p>Puna me projektet kërkimore në FSHN, ka si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore. Kështu studentët inkurajohen të zhvillojnë ide</p>

	inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ ka konstatuar se Universiteti i Tiranës ka marrë pjesë në disa projekte ERASMUS. Nëpërmjet tyre institucionin mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri të cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtare të tjerë të personelit akademik. [Evidenca 44 – Projekte kërkimore 2018 – 2021] [Evidenca 103 – Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshje Bilaterale]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e përgjithshme të UT është përcaktuar se diplomimi i studenteve në përfundim të ciklit të parë behet me provim formimi. Ngritja e komisionit të provimit është e përcaktuar në rregullore, ai propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani, përbërja është me 5 anëtarë nga DI. Për përgatitjen e provimit përfundimtar DI ka përcaktuar rregullat dhe mënyrën se si do të zhvillohet. Lëndët dhe temat që studentët duhet të përgatitet u behën të dituar studenteve përgjatë semestrit të VI, DI organizon edhe konsultime në varësi të kërkesave të studenteve. Në çdo rast studentët komunikojnë me kujdestaret e grupeve dhe me koordinatorin e programit të studimit. Në takimin me studente u evidentua që mekanizëm kishte funksionuar dhe studentët ishin duke u përgatitur për provimin përfundimtar. [Evidenca 6 - Rregullore e UT] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Gjate takimit me studentët u evidentua se ato asistoheshin nga kujdestaret e grupeve, koordinatori i programit të studimit dhe nga përgjegjësi i DI në takime informuese që

<p>duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>zhvilloheshin përgjatë vitit të 3-të. Studentët ndihmoheshin me temat përkatëse që duhet të përsëriteshin si edhe me modele të viteve të mëparshëm të tezave.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në përgatitjen e tezës së provimit përfundimtar komisioni i provimit bazohet në 4 lëndë bazë të programit të studimit, ato dhe temat kyçe u behën të ditura studenteve përgjatë vitit të 3-të studimit. Bazuar në DVV lëndët kryesore janë pjese e tezës së provimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programim dhe strukture të dhënash; • Programim i orientuar nga objekti C++; • Administrim dhe siguri të dhënash; <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 102 - Model teze provimi diplome TIK]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe shënimeve të takimeve evidentohet se Përgjegjësi i Departamenti DI në bashkëpunimi me stafin akademik harton programin orientues për provimin e diplomës me të cilën studentët ishin njohur tashme nëpërmjet takimeve informuese dhe faqes web.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 45 – Rregullore Diplomimi për programet e ciklit të parë FSHN]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Programi i studimit mbyllet me provim përfundimtar, për përgatitjen e tij institucioni vë në dispozicion ambientet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit në .</p> <p>[Evidenca 45 – Rregullore Diplomimi për programet e ciklit të parë FSHN]</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Ky program studimit mbyllet me provim përfundimtar, departamenti DI dhe njësia kryesore FSHN angazhohen maksimalisht me mbarëvajtjen e tij. Studentët asistohen në konsultimeve që zhvillohen në periudha të caktuara në varësi të nevojave të tyre, gjithashtu institucioni u vë në dispozicion edhe salla studimi, mjediset laboratorike për realizimin e temave përkatëse. [Evidenca 45 – Rregullore Diplomimi për programet e ciklit të parë FSHN]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Vlerësimi i provimin përfundimtar behet me note, bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse të diplomimit. Vlerësimet me notë janë nga 1 në 10, ku nota</p>

<p>diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>më e ulët për kalim është 5. Vlerësimi i provimit përfundimtar pasqyrohet të proces-verbalin përkatës dhe depozitohen në sekretarinë mësimore konform rregullores së përgjithshme të UT-së. Këto proces-verbale firmoseshin nga të gjithë anëtarët e komisionit të diplomimit. [Evidenca 45 – Rregullore Diplomimi për programet e ciklit të parë FSHN]</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në DVV, të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar me sukses studimet dhe kanë plotësuar kërkesat e plota për procedurën e diplomimit, si kërkesa për fitimin e të gjitha krediteve ECTS, notën kaluese në provimin përfundimtar, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Në përfundim të gjithë studentët pajisen me diplomën përkatëse. Diploma e lëshuar është miratuar nga Senati i UT-së dhe ministria përkatëse.</p> <p>Nga takimi në sekretarinë mësimore u konstatua që studenti kur pajiset me diplomë, në përfundim të studimeve, nuk pajiset edhe me suplementin e saj. Studenti ka të drejtë të kërkojë pranë sekretarisë mësimore që të pajiset me suplementin e diplomës, dhe vetëm në këtë rast, sekretaria e harton dhe e dorëzon atë tek studentit me kërkesë të tij.</p> <p><i>Bazuar në aktet ligjore në fuqi, dhe në veçanti, VKM 185, date 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar, Pika 1, gërma ç, Sekretaria mësimore e ka detyrim ligjor të pajisë studentët me diplomë dhe me suplementin e diplomës kur ata diplomohen.</i></p> <p>Detyrime të cilat nuk janë të reflektuara në rregulloren përkatëse të sekretarisë mësimore në lidhje me dokumentacionin që duhet të krijojë për studentët e diplomuar.</p> <p><i>Rekomandojmë institucionin të përshtat aktet e brendshme rregullatore me ato ligjore në fuqi, në rastin konkret për sekretarinë mësimore.</i></p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 8 - Suplement Diplome Bachelor në TIK]</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material është i përgatitur në dy gjuhë, fakt që ndihmon studentin kur shkon jashtë shtetit për studime ose punësim. [Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Të gjitha dokumentet e studentëve gjatë ciklit të studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave ligjore, një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentore në të njëjtën mënyrë siç ishte gjatë periudhës së studimit. Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga institucione të tjera. Gjithashtu ka kërkesë të veçantë të studentëve për lloje të ndryshme të dokumenteve që konsiderohen si raste ose kërkesa të veçanta.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shënime në vizitë UT/FSHN]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor de administrativ.</p>	<p>Në bazë të organigramës së FSHN, dy njësitë përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit është Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës. Gjatë vizitës në Institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi që disponohet dosje e plotë për çdo personel akademik të brendshëm (fleta prezantuese e dosjes teknike, CV, kontratë pune, diplomat e arsimimit të të gjithë cikleve, lista e notave, dëshmitë e gjuhëve të huaja, librezë e punës, shkresa e emërimit, librezë pune etj). Në çdo fillim viti hartohet tabela e ngarkesës individuale për çdo semestër dhe vjetore, e detajuar me të gjithë elementet e udhëzimit 29, datë 10.09.2018 lidhur me orët brenda dhe jashtë auditorit (udhëheqje diplomash, doktoratash, juri etj.) Hartohen tabelat e realizimit të</p>

	<p>ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë programit bachelor, nga personeli akademik i brendshëm efektiv (PAE) dhe të pjesshëm/ftuar (PAK) të detajuara me lëndët/modulet dhe orët për çdo semestër. Çdo element i përmendur për këtë kriter është i shoqëruar me evidencën përkatëse dhe të plotësuar në mënyrë korrekte.</p> <p>[Evidenca 14 - CV Stafit Akademik PAE], [Evidenca 15 – CV Stafit Akademik PAK], [Evidenca 17 – CV Stafit Ndhmës Akademik], [Evidenca 86 - Model Kontrate]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura dhe verifikimi në Institucion, Departamenti zbaton procedura të përcaktuara qartë për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të sanksionuara në Statut, Rregullore të UT dhe në kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Kërkesa për rekrutim të stafit akademik (me kohë të plote dhe të pjesshme) dhe stafit ndihmës – akademik buron nga Departamenti i Informatikës. Punësimi realizohet me procedurë konkurrimi të hapur përmes garantimit të një procesi të drejtë dhe transparent. Për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore, Departamenti i Informatikës çdo vit, pas planifikimit të ngarkesës vjetore për stafin PAE fton edhe personel akademik me kontratë të përkohshme ose paraqet kërkesën e tij për staf PAK dhe i paraqet Dekanatit të FSHN-së listën me propozimet për personelin akademik pas një diksutimi paraprak në departament.</p> <p>Në takimet e zhvilluar në institucion u theksua vështirësia që Departamenti i Informatikës ka në lidhje me plotësimin e kërkesave të tyre për personel akademik me kohë të plotë. Konkretisht për vitin 2020-2021 ky departament ka kërkuar shtimin e personelit me 6 pedagogë të rinj për të rritur cilësinë në mësimdhënie dhe për të ulur ngarkesën mësimore por akoma vendet vakante nuk janë plotësuar.</p> <p>Kërkesat për tre vitet e fundit janë refuzuar nga ana e Rektoratit të UT-së dhe Bordit të Administrimit për mungesë të fondeve.</p> <p><i>GVJ rekomandon plotësimin më staf akademik për të garantuar cilësinë në mësimdhënie.</i></p> <p>[Evidenca 86 - Model Kontrate], [Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës], [Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për</p>	<p>UT dhe në veçanti Departamenti i Informatikës zbaton procedura dhe kritere të posaçme për rekrutimin e personelit</p>

<p>rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>akademik të përshkruara në Statut, Rregullore UT dhe Rregullore të DI të cilat bazohen tek konkurrimi dhe të bëra publike në faqet web dhe në APP.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës], [Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p>																					
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Informatikës ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi për personel akademik të parashikuara në detaje në kornizën ligjore të UT/FSHN/DI. Këto procedura konkurimi garantojnë transparencë dhe meritokraci.</p> <p>Megjithatë, në proceurat e rekrutimit, edhe pse të standardizuara në nivel institucional, sistemi i pikëzimit të kandidatëve nuk është uniform. Gjatë vizitës u konstatua përdorimi i një sistem vlerësimi të kandidatëve që vendosej nga anëtarët e komisionit ad-hoc dhe aspak bazuar në një procedurë të aprovuar paraprakisht. Praktikisht, janë kandidatët e komisionit ad-hoc që vlerësojnë pikët që kriteret e ndryshme kanë në vlerësimin total të kandidatëve, duke caktuar pikë për publikimet në revista, pjesëmarrje në konferenca, eksperiencia të mëparshme në mësimdhënie etj.</p> <p>Për sa më sipër, GVJ rekomandon:</p> <p><i>Miratimin e një procedure pikëzimi të standardizuar dhe peshe specifike për cdo kriter vlerësues. Informacione që duhet të jenë publike përpara pranimit të kandidaturave për vendet vakante.</i></p> <p>Në përfundim të procesit personeli akademik i rekrutuar nënshkruan kontratë pune të rregullt me UT bazuar në kornizën ligjore në fuqi, e cila gjendet në dosjen personale në Burimet Njerëzore. Personeli akademik që mbulon Programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe komunikimi, ka kualifikimin në nivelin e duhur, ku për vitin akademik 2020-2021 ka qenë i përbërë si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="576 1496 1358 1890"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>9</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr. në proces</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>6</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>20</td> <td>16</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	0	1	Prof. Asoc.	0	1	Dr./PhD	9	3	Dr. në proces	5	1	Msc.	6	10	Total	20	16
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	0	1																				
Prof. Asoc.	0	1																				
Dr./PhD	9	3																				
Dr. në proces	5	1																				
Msc.	6	10																				
Total	20	16																				

	[Evidenca 14 - CV Stafit Akademik PAE], [Evidenca 15 – CV Stafit Akademik PAK], [Evidenca 17 – CV Stafit Ndhimës Akademik], [Evidenca 13 – Tabelat Ngarkesa] [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Informatikës, konstatohet një infrastrukturë e përshtatshme për çdo personel akademik duke siguruar barazi por edhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari të personelit akademik të Departamentit të Informatikës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, u vu re se një pjesë e ambienteve, paraqesin një qasje jo të duhur për personat me aftësi ndryshe apo me aftësi të kufizuara. Në disa ambiente, qasja realizohet vetëm nëpërmjet shkallëve të cilat paraqesin një barrierë arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara mobiliteti.</p> <p><i>Rekomandojmë që institucioni të marrë masa për të svogëluar barrierat arkitektonike duke garantuar një qasje më gjithëpërfshirëse në institucionin.</i></p> <p>[Evidenca 18 – Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimit] [Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e Departamentit të Informatikës]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura, rezultojnë se Departamenti i Informatikës, në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UT, planit të kërkimit shkencor të zhvillimit të UT, planit strategjik të programit të studimit ka krijuar mundësitë që personeli akademik, të kryejë mobilitete për trajnim/mësimdhënie apo dhe kontribute të tjera në kuadër të programeve ERASMUS etj. Gjithashtu sigurohet edhe mbështetje financiare për aktivitete botuese apo referuese në</p>

	<p>veprimtari shkencore jashtë vendit, sidomos të personelit që aspirojnë titull akademik.</p> <p>Procedura e financimit të veprimtarive botuese apo referuese që menaxhohet në rang fakulteti është e qartë, <i>por mund të përmirësohet për të siguruar optimizim të fondit me qëllim rritjen e mbështetjes të sa më shumë veprimtarive kërkimore të personelit akademik.</i></p> <p>Departamenti i Informatikës është pjesëmarrës në projektin “The power-shkenca e te dhënave dhe teknologjia” (https://fshn.edu.al/notifications/the-power-shkenca-e-te-dhenave-dhe-teknologjia) i cili synon ofrimin e trajnimeve për studentët e nivelit bachelor, master dhe doktorantë të institucionit (FSHN, UT), lektorë dhe kërkues shkencor pranë institucionit. Departamenti ka patur dhe pjesëmarrje dhe bashkëpunime në kuadër projektesh të tjera. Personeli akademik angazhohet për kualifikimin e tyre.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021] [Evidenca 103 – Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshje Bilaterale [Evidenca 104 - Thirrja për bursa në Programin Erasmus (Staf Akademik)] [Evidenca 105 - Thirrja për bursa në Programin Erasmus (Student)]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Departamenti i Informatikës, si pjesë integrale e UT, rezulton eficient në përdorimin e metodave inovatore të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e reja, siç ishte rasti i përdorimit të tyre gjatë mësimdhënies dhe kryerjes së provimeve “on-line” në distance gjatë kohës së pandemisë së COVID-19. Ky proces është i sanksionuar dhe i inkuadruar në Udhëzues dhe Rregullore zyrtare të miratuar të UT. Gjithashtu UT mbështet iniciativat kërkimore-shkencore të personelit nëpërmjet financimit të projekteve konkurruese të personelit akademik. Në mbështetje të përdorimit të metodave të ndryshme inovatore të mësimdhënies është laborator i Inxhinierisë Matematike dhe Informatike i kompletuar.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021] [Evidenca 32 – Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në DI] [Evidenca 60 - Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë]</p>

	[Evidenca 39 – Raporti mbi sondazhin e mësimit online]																							
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Për të përmbushur objektivat e programit të studimit, Departamenti i Informatikës kryen një organizim dhe shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës mësimore në auditor dhe asaj kërkimore sipas kualifikimit të çdo personeli akademik, duke shmangur mbingarkesat. Respektohet korniza ligjore në fuqi që ngarkesa të jetë deri në 200 orë mbi normën vjetore sipas kualifikimit përkatës. Gjithashtu kjo realizohet edhe me bashkëpunimet me personelin akademik të Departamenteve të Matematikës, Matematikës së Aplikuar, Fizikës, etj.,</p> <p>Nga evidentimi i bërë ngarkesës mësimore, konstatohet:</p>																							
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>3942</td> <td>2795</td> <td>1147</td> <td>71% / 29 %</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>3282</td> <td>2262</td> <td>1020</td> <td>69% / 31%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2470</td> <td>1745</td> <td>725</td> <td>71% / 29%</td> </tr> </tbody> </table>				Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2018-2019	3942	2795	1147	71% / 29 %	2019-2020	3282	2262	1020	69% / 31%	2020-2021	2470	1745	725	71% / 29%
	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																			
	2018-2019	3942	2795	1147	71% / 29 %																			
2019-2020	3282	2262	1020	69% / 31%																				
2020-2021	2470	1745	725	71% / 29%																				
<p>Në këtë mënyrë respektohet raporti i duhur i kërkuar nga korniza ligjore. Në dispozicion ka dhe një personel ndihmës-akademik të vetin, por edhe mbështetjen e personelit të specializuar të FSHN për shërbime të caktuara.</p>																								
<p>[Evidenca 13 – Tabelat Ngarkesa]</p> <p>[Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK]</p>																								
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																				
				X																				

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në	Departamenti i Informatikës, si pjesë integrale e FSHN zhvillon procesin mësimor në 4 godina që disponon ky fakultet. Duke parë evidencën e shpërndarjes, rezulton se hapësirat në dispozicion të realizimit të procesit mësimor (leksione dhe seminare) janë të mjaftueshme dhe të pajisura

<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>mjaftueshëm nga pikëpamja infrastrukturore në dispozicion të studentëve sipas natyrës së moduleve respektive.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, u vu re se një pjesë e ambienteve, paraqesin një qasje jo të duhur për personat me aftësi ndryshe apo me aftësi të kufizuar. Në disa ambiente, qasja realizohet vetëm nëpërmjet shkallëve të cilat paraqesin një barrierë arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar mobiliteti.</p> <p><i>Rekomandojmë që institucioni të marrë masa për të svogëluar barrierat arkitektonike duke garantuar një qasje më gjithëpërfshirëse në institucion.</i></p> <p>[Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e Departamentit te Informatikës]</p> <p>[Evidenca 18 – Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimit]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktivitete mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. Njëkohësisht edhe hapësira në dispozicion të personelit akademik është mëse e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore.</p> <p>[Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN]</p> <p>[Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e Departamentit te Informatikës]</p> <p>[Evidenca 18 – Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimit]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Duke u nisur nga natyra konkrete e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, ambientet e nevojshme për të realizuar objektivat e këtij programi, janë kryesisht për leksione dhe seminare. Ndërsa për disiplinat që kanë të nevojshme pajisje laboratorike për zbatimet kompjuterike, në dispozicion, janë disa ambiente laboratorike që shfrytëzohen jo vetëm për këtë program studimi, por edhe për programet e tjera të kësaj njësie bazë.</p> <p>Njësia bazë, departamenti i Informatikës, ka në dispozicion disa laboratorë informatike si vijon:</p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dy laboratorë me 32 PC në total, i përdorur kryesisht për zhvillimin e lëndëve të programimit në gjuhën C/C++; 2. Një laborator me 24 laptop, për zhvillimin e lëndëve me programim në JAVA; 3. Një laborator IoT me 16 PC; 4. Një laborator me 16 laptop, për zhvillimin kryesisht të lëndëve në bazë të dhënash SQL; 5. Një laborator GIS me 15 workstations; <p>Megjithatë, duke parë numrin e programeve të studimit që ofrohen nga njësia bazë, departamenti i Informatikës si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bachelor në Informatikë; 2. Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; 3. Master i Shkencave Informatike; 4. Master i Shkencave Teknologji Informacioni; 5. Master i Shkencave AML Informatike; 6. Master Profesional Informatike Biznesi; 7. Master Profesional Teknologji Informacioni; <p>Numrin total të studentëve, numrin e grupeve mësimore, planin mësimor dhe numrin e orëve laboratorike,</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të rrisë numrin e ambienteve informatike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve laboratorike të parashikuara në planet mësimore të programeve përkatëse të studimit që ofron.</i></p> <p>[Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Bsc. TIK] [Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 24 – Raporti Vjetor i DI 2021 – 2022] [Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e DI] [Evidenca 18 – Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimimit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Informatikës ka në dispozicion disa laboratorë informatike të pajisur me infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë informacionit, hardware dhe atë software në shërbim të objektivave të aktiviteteve mësimore të disiplinave specifike që kërkojnë një infrastrukturë të tillë.</p> <p><i>Është e nevojshme shtimi i kapaciteteve kompjuterike për laboratorët ekzistues, të tillë që së paku një student i grupit laboratorik, të ketë në dispozicion një kompjuter.</i></p> <p><i>Është e nevojshme shtimi i numrit të laboratorëve informatik në tërësi.</i></p> <p>[Evidenca 24 – Raporti Vjetor i DI2021 – 2022] [Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e DI]</p>

	[Evidenca 18 – Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimit]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>Programi i studimit nuk parashikon praktikë profesionale të mirëfilltë. Dhe në këtë kuadër, studentët nuk e kanë detyrim zhvillimin e praktikave profesionale pranë kompanive apo institucioneve në fushën e këtij programi studimi. Megjithatë, Departamenti i Informatikës ka lidhur disa marrëveshje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me disa kompani si dhe shfrytëzon dhe marrëveshjet me FSHN/UT, që studentët të kenë mundësi për praktika, internshipe por edhe seminare të përbashkëta. Institucioni garanton kushtet e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo edhe qasje WiFi në internet. Megjithatë, në momentin e vizitës, jo të gjitha ambientete e FSHN-së, që aksesohen nga studentët, kishin qasje WiFi në të gjitha ambientet e FSHN-së. Sipas bisedimeve gjatë vizitës, është në planin afatshkurtër të institucionit zgjerimin e mbulimit me sinjal WiFi në të gjithë ambientet. Gjithashtu në dispozicion është dhe biblioteka e FSHN.</p> <p>[Evidenca 25 – Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016 – 2021]</p> <p>[Evidenca 69 - Shembull marrëveshje me kompani të ndryshme në fushë e Teknologjisë së Informacionit]</p> <p>[Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimit, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimit dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimit për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion e GVJ, u konstatua që në dispozicion të studentëve është biblioteka e FSHN. Kjo bibliotekë ofron ambientet e nevojshme fizike për të përbashkuar një frekuentim mesatar ditor rreth 140 studentë e pedagogë. Gjithashtu ajo ofron komoditet në ajrim dhe ngrohje. Është e pajisur me fond të pasur zërash, duke ofruar literature hardcopy dhe online. Kjo bibliotekë funksionon me



	<p>dy turne dhe në mbështetje të saj ka një numër stafi të mjaftueshëm për të përballuar frekuentimin ditor.</p> <p>Në tërësi, biblioteka e FSHN ofron 92 poste studimi në fondin e hapur të librit, 4 vende në ambjentin e shërbimit të fondit kryesor, 44 vende në fondin e hapur të periodikut.</p> <p>Megjithatë, duke analizuar edhe numrin e lartë të programeve të studimit të ofruara në FSHN, ne si <i>GVJ gjykojmë se numri i vendeve të bibliotekës të mund të shtohet për të mbuluar sa më mirë numin e studentëve aktual por edhe atyre në prespektivë në rritje për programet e studimit.</i></p> <p>[Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN] [Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron në total rreth 80018 tituj: tekste mësimore universitare, disertacione, revista dhe periodikë shkencore në shqip dhe në gjuhë të huaj. Gjatë vizitës në Institucion, konstatohet një mbulim i të gjithë disiplinave të programit mësimor me literaturën bazë, dhe me ato të rekomanduara të cilat janë në bibliotekë.</p> <p>[Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN] [Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet që studentëve ju sigurohet qasje e barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat online, siç është ajo Ulibrary dhe disa të tjera biblioteka digjitale dhe platformë online që ofrojnë literaturë në gjuhë të huaj JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP. në të cilat mundësohet qasje elektronike e studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet llogarive personale. Edhe nga biseda e GVJ me studentët u konstatua ky realitet.</p> <p>Digjitalizimi i bibliotekës së FSHN është në proces. Me përfundimin e këtij procesi, do të sigurohet qasje më e mirë dhe e plotë për studentët. Gjithashtu në proces është edhe rrjeti për t'u pajisur me internet.</p> <p><i>GVJ sygjeron që sallat në dispozicion të studentëve duhet të pajisen me pc dhe sinjal wifi.</i></p> <p>[Evidenca 12 – Infrastruktura FSHN] [Evidenca 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të</p>	<p>Biblioteka në dispozicion të studentëve aktualisht ka 2 kompjutera me akses në internet dhe për shfrytëzimin e</p>

<p>tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>burimeve online, të pajisura me programet e nevojshme kompjuterike.</p> <p><i>Ndoshta kjo sasi është disi e vogël për të përballuar fluksin e studentëve në ditë. Duhet të rritet sasia e pc në bibliotekë dhe mbulimi me wifi.</i></p> <p>Studentët e këtij programi studimi kanë qasje në internet edhe nëpërmjet laboratorëve didaktik të Departamentit të Informatikës që mund ti përdorin kur nuk ka angazhime laboratorike.</p> <p>[Evidenca 16 - Infrastruktura Laboratorike e Departamentit të Informatikës]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Konstatohet që UT/FSHN aplikon për çdo vit një procedurë duke filluar nga propozimi i njësisë bazë për pasurimin e fondit ekzistues me tituj të rinj: libra, abonime online etj., e deri në miratimin dhe shtimin e tyre në fondin e bibliotekës.</p> <p>[Evidenca 48 – Parashikimi i Projekt Buxhetit]</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Rezulton që biblioteka është në dispozicion të studentëve në një orar të gjerë, 8.00-20.00 nga e hëna në të enjte dhe 8:00-18:00 ditën e premte, mbështetur edhe nga staf administrativ përkatës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi</p>	<p>Nga evidencat dhe vizita në Institucion, rezultojnë që Sekretaria Mësimore e FSHN si detyrim ligjor të Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015 dhe rregullores së UT, administron gjithë informacionin që lidhet me studentët: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të studentëve, të cilat arkivohen në arkivat e</p>

<p>deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>shtetit dhe në funksion të këtyre administron: dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e provimeve dhe detyrimeve, dosjet e transferimit të studentëve, statistika të frekuentimit të studentëve, të studentëve që çregjistrohen, dosjet e diplomimit etj. Të gjitha këto arkivohen në arkivin e sekretarisë mësimore dhe shërbejnë si bazë për dhënien e informacioneve zyrtare nga sekretaria.</p> <p>Është në proces ndërtimi i sistemit te ri elektronik për administrimin e të dhënave për studentët dhe lidhjen e tij me sistemin qeveritar <i>e-albania</i>.</p> <p>Gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov.2 (Covid-19), institucioni ka përdorur me sukses edhe sisteme të tjera informatike në funksion të aktiviteteve didaktike, sikurse është paketa Microsoft Office 365, ku në të përfshihet edhe moduli i komunikimit online Microsoft Teams. Në këtë platformë, studentët, pedagogët dhe stafi ndihmës akademik kanë qasje bazuar me kredencialet institucionale në domain @unitir.edu.al.</p> <p>Ku studentët kanë adresa të postës elektronike në formatin:</p> <p>Emër.mbiemër@fshnstudent.info</p> <p>Emër_mbiemër.fshnstudent@unitir.edu.al</p> <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT]</p> <p>[Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]</p> <p>[Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams]</p> <p>[Evidenca 53 – Llogari në MS Teams pedagogu]</p> <p>[Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p> <p>[Evidenca 55 – Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë)]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura dhe vizita në Institucion, rezultojnë që Dega e Burimeve njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës, janë sektorët që administrojnë gjithë informacionin e duhur për personelin akademik (efektiv dhe me kontratë), ndihmës akademik dhe administrativ, informacion ky që konsiston nga i gjithë dokumentacioni lidhur me arsimimin, përparimin akademik, procedurat e punësimit dhe kontratat e punës së secilit. Këto të dhëna përditësohen vazhdimisht në varësi të përparimit të secilit, sipas aktivitetit përkatës. Gjatë vizitës në institucion, gjatë shqyrtimit rastësor të disa prej dokumentacionit të stafit</p>

	<p>akademik PAE dhe atij PAK, u vu re së në disa prej tyre kishte mangësi informacioni, apo informacion jo të azhurnuar.</p> <p><i>Mungonin lejet e universitetit nga vjen për personelin akademik me kohë të pjesshme. Është detyrim ligjor që duhet të kërkohet dhe të ndodhet në dosjen e personelit përkatës akademik me kohë të pjesshme të aktivizuar në këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencës së paraqitur, rezulton që sistemi i menaxhimit siguron akses studentëve dhe personelit akademik, i cili është konfidencial në respekt të ruajtjes së të dhënave personale dhe mundësohet nëpërmjet llogarive personale. Studentët kanë në dispozicion portal elektronik nëpërmjet aksesit individual në të cilin ai kryen regjistrimin për kurset që do të frekuentojë, njohjen me rezultatet në provime etj. Gjithashtu në faqen zyrtare elektronike, studenti nëpërmjet aksesit individual mund të sigurojë faturat për tarifatat e studimit, listë notash, certifikata apo dhe programet mësimore. Akses elektronik i sigurohet edhe personelit akademik, ndihmës akademik dhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të institucionit dhe sekretarisë mësimore, nuk parashikon mundësinë e hedhjes dhe ruajtjes së detyrimeve lëndore të studentëve. Detyrime që janë parakusht për të lejuar pjesëmarrjen në provim. Detyrime si frekuentimi, shlyerja e laboratorëve apo e projekteve dhe detyrave të kursit. Ky detyrim mirëmbahet vetëm nga pedagogu i lëndës, i cili, edhe pse ka në dispozicion listën e studentëve të grupit që ka provim, të hartuar nga sekretaria mësimore, mund të mos lejojë student të zhvillojnë provimin, pasi ka detyrime lëndore të pa shlyera. Mbjakta e informacionit rreth shlyerjes së detyrimeve të lëndës nga pedagogu për secilin student, mund të paraqesin vështirësi në transmetimin e këtij informacioni në rast të ndërrimit të pedagogut të lëndës, apo në rast të studentëve që frekuentojnë lëndën në një vit akademik, por për motive nga më të ndryshme, zhvillojnë provimin e saj, në vitet pasardhëse akademike.</p> <p><i>Është i nevojshëm një sistem elektronik të jetë më dinamik dhe i plotë, ku pedagogët të deklarojnë detyrimet dhe vlerësimet e studentëve dhe nga i cili studenti jo vetëm të kryejë regjistrimet për provime por të marrë edhe shërbime të tjera lidhur me arritjet e tij akademike.</i></p>

	<p><i>Sistemi i sekretarisë mësimore duhet të administrojë avancimin akademik të studentit, edhe për argumentet e veçanta të secilës lëndë të parashikuara në programin e saj, duke lehtësuar pedagogun e lëndës nga mbajtja e të dhënave administrative të kësaj fushe.</i></p> <p>Megjithatë, GVJ vlerëson se informacioni i ruajtur nga sekretaria mësimore, bazohet në rregulloren institucionale të Universitetit të Tiranës, dhe nuk është në përgjegjësi apo kompetencë të këtij programi studimi. Njësia bazë, mund të sugjerojë që këto informacione të shtohen në të dhënat e menaxhuara nga sekretaria mësimore.</p> <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT]</p> <p>[Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga GVJ u konstatua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimt, ashtu edhe jashtë saj. Komunikimi mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ zhvillohet edhe nëpërmjet postës elektronike zyrtare në domain të institucionit, ashtu edhe në modulet e përdorura për komunikim online si Microsoft Teams. Institucioni përdor edhe faqen online institucionale të FSHN lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit, informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj. Njëkohësisht, komunikim kryhet edhe nëpërmjet faqes së Departamentit, në të cilën janë të detajuara edhe të dhënat për secilin nga personeli akademik. Në përgjithësi, i gjithë personeli ka paraqitur të dhëna lidhur me arsimimin, titujt, botimet dhe disiplinat që mbulon.</p> <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT]</p> <p>[Evidenca 53 – Llogari në MS Teams pedagogu]</p> <p>[Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p> <p>[Evidenca 55 – Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë)]</p> <p>[Evidenca 74 - Microsoft-office-365-për-student]</p> <p>[Evidenca 75 - e-Student UT Manual përdorimi – Pedagogët]</p> <p>[Evidenca 76 - Sistemi e-Student Manual përdorimi]</p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është platforma TEAMS, faqet zyrtare të UT dhe FSHN ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT]</p> <p>[Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT, faqes elektronike të FSHN si dhe asaj të departamentit, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor dhe syllabuset e çdo disiplinë. Konstatohet që syllabuset e shkurtuara janë të paraqitura në faqe të departamentit. Japin informacion lidhur me objektivat e lëndës, konceptet themelore, strukturën e disiplinës si dhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p>[https://fshn.edu.al/]</p> <p>[https://unitir.edu.al/eng/]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstatoi edhe nga biseda me grupet përkatëse se ekziston një procedurë plotësisht e përcaktuar e propozimit dhe miratimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm të institucionit ku përfshihet edhe ajo e departamentit, e cila mbulon kostot e programit të studimit dhe nevojave për mbështetje financiare për aktivitete botuese. Kjo procedurë fillon që nga njësia bazë dhe në mënyrë progresive në nivelet më lart Fakulteti dhe gjithë universiteti dhe është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Informacionet/raportet</p>

	<p>për buxhetin publikohen nga FSHN. Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore.</p> <p>[Evidenca 48 – Parashikimi i Projekt Buxhetit]</p> <p>[Evidenca 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit rezulton të përfshijë gjithë financimet e burimeve njerëzore që i shërbejnë realizimit të programit, si ato për shpenzime operative, edhe ato për abonimet online, pasurimin e bibliotekës, mbështetje për botimet shkencore etj. Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore.</p> <p>[Evidenca 48 – Parashikimi i Projekt Buxhetit]</p> <p>[Evidenca 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p> <p>[https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Auditimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar të institucionit përveç organizmave të auditit të KLSH dhe MAS, ka dhe sektorin e auditit të brendshëm nën varësinë e Bordit të Administrimit i cili kryen në mënyrë periodike auditimin dhe raporton përpara Bordit të Administrimit. Raportet financiare përmbajnë në mënyrë të hollësishme situatën financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare sipas zërave të aktiviteteve dhe sipas departamenteve. Auditimet zhvillohen në përputhje me Programin e Transparencës së Universitetit të Tiranës.</p> <p>[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/Urdher-Nr.8-dat%C3%AB-30.03.2021.pdf]</p> <p>[https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/]</p> <p>[Evidenca 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p> <p>[https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet</p>	<p>Rezultoni që raportet dhe analizat financiare të hartuara nga universiteti në fund të çdo viti dhe për vitet akademike paraardhëse, ruhen në respektim të akteve ligjore dhe</p>

e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	nënligjore për arkivë-protokollin. Planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme parashikohen në buxhetet afatmesme për të garantuar mbarëvajtjen normale të programeve të studimeve. [Evidenca 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN] [https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]
--	--

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Me miratimin e buxhetit nga Bordi i Administrimit, si një përmbledhje e harmonizuar e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e të gjithë strukturave të universitetit në mbështetje të plotë të nevojave të gjithanshme për realizimin e misionit dhe objektivave të universitetit në tërësi dhe programeve të studimit në veçanti, garantohet qëndrueshmëria financiare e gjithë periudhës së zhvillimit të programit të studimit. UT rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (grantet e MAS, të ardhurat nga studentët dhe të ardhura nga shërbime për të tretë etj.) ekzistuese për të realizuar objektivat e tij. <i>Duhet të shtohen akoma më tepër zërat financiare për mbështetje të veprimtarive botuese të personelit akademik si dhe për të organizuar dhe mbështetur veprimtari të përbashkëta shkencore me studentët.</i> [Evidenca 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN] [https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]
---	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rezulton që pranimi i studentëve kryhet mbi bazën e procedurave të parashikuara nga korniza ligjore në fuqi dhe mbi bazën e kuotave të miratuara nga MAS. E gjithë procedura e propozimit të kuotave, miratimit të tyre, procedurat e përzgjedhjes së tyre, rregullat e vlerësimit dhe frekuentimit, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të tyre, ndjekja e një program të dytë studimit, të diplomimit të tyre, janë të sanksionuara në Statutin e UT, Rregulloret e UT, FSHN, DI dhe programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 1 – Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës] [Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit “Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kuotat dhe kriteret pasi janë hartuar dhe miratuar në njësinë bazë, dhe miratuar nga të gjitha hallkat brenda UT, miratohen edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin duke u bërë publike edhe në portalin U-Albania për të gjithë kandidatët studentë në të gjithë vendin. Mënyra e pranimit dhe regjistrimit kryhet në përputhje me aktet ligjore të lëshuara nga MAS për të gjithë kandidatët-studentë të vendit në çdo vit akademik, duke respektuar gjithë instancat e përfshira në të që nga njësia bazë derisa shpallen fituesit nga FSHN pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit përkatës.</p> <p>Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me përparimin e studentëve, frekuentimin e tyre, përfaqësimin e tyre në organet drejtuese etj. janë të rregulluara nëpërmjet dokumenteve zyrtare të UT, Statutit të UT, rregullores së UT, dhe rregullores së programit të studimit. Në to janë të pasqyruara qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve, të cilat garantojnë barazinë ndërmjet tyre.</p> <p>Gjithashtu barazia dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, garantohet edhe nga elemente të tjerë të rëndësishëm informimi siç janë: faqja elektronike e FSHN, e departamentit, informimi nëpërmjet adresave personale elektronike për çdo student, pjesëmarrja e studentëve në këshillat studentore, në senat, në Bordin e Administrimit, në Komisionet e ndryshme të UT. Garantohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete shkencore dhe sociale.</p> <p>Ata informohen për mundësitë e reduktimit të tarifave të studimit sipas akteve ligjore, informohen në mënyrë të</p>

	<p>barabartë për mundësitë e mobiliteteve në programe të ndryshme europiane, kanë mundësi këshillimi me psikologun e FSHN kanë të përcaktuar për çdo vit studimi një Kujdestar Akademik dhe pjesëmarrja në veprimtari të tjera akademike dhe sportive apo dhe pjesëmarrje në mobilitete Erasmus. Në nivel institucional është ngritur Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Gjithashtu, informacione të mjaftueshme për veprimtaritë e mësipërme gjenden në faqen web të UT, FSHN dhe Departamentit.</p> <p>[Evidenca 1 – Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës] [Evidenca 6 – Rregullore e UT] [Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, që nga përcaktimi dhe miratimi i kuotave dhe kriterëve për një program studimi, UT/FSHN përveç procedurave të unifikuara dhe të sanksionuara në aktet ligjore të Qeverisë dhe MAS të Republikës së Shqipërisë, të cilat bëhen transparente për publikun nga QASH dhe të cilat janë të pasqyruara edhe në dokumentet zyrtare ligjore të tij: Statuti, Rregulloret etj, kryen edhe procedura të tjera në shërbim të aksesimit sa më të gjerë për publikun: merret pjesë në ditët e informimit të maturantëve ku pedagogë të Departamentit të Informatikës marrin pjesë për të informuar maturantët me procedurat, kriteret dhe informacione të tjera që lidhen me programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni; shpërndahen fizikisht dhe në faqen web (FSHN) udhëzuesin dhe fletëpalosjen e përgatitur me gjithë informacionet e nevojshme për maturantët. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës pranë FSHN jep informacion mbi programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Kjo zyrë mbështet studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit. Kjo degë, organizon “Javën orientuese” në javën e parë të vitit akademik si një javë orientuese dhe informuese për studentët e vitit të parë, ku studentët njihen me elementet e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, me kurrikulën mësimore që ata do të zhvillojnë gjatë ciklit të tyre të studimit, me organizimin e institucionit, me të drejtat dhe detyrat e tyre, me jetën studentore etj. Për çdo vit akademik, Departamenti cakton dhe Kujdestarin Akademik si këshillues permanent i studentëve të vitit përkatës. Informimi kryhet edhe nga çdo</p>



	<p>personel akademik përkatës i disiplinës përkatëse. Njëkohësisht studentët e marrin këtë informacion edhe ndërmjet dokumenteve zyrtare në faqen web të FSHN dhe Departamentit.</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Çdo vit akademik vendosen kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi". Kjo realizohet në bazë të procedurës së përcaktuar në Statutin e UT, në përgjigje të kërkesës së MAS, me propozim të Departamentit të Informatikës, miratim të senatit të UT dhe vendim të MAS. Këto kritere të pranimit publikohen në faqen zyrtare të UT, FSHN dhe Departamentit të Informatikës, si dhe shpërndahen nëpërmjet broshurës "Mbi programet e studimit dhe kriteret e pranimit" dhe fletëpalosjes". Kriteret e pranimit" tek maturantët.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 19 – Kuotat e Pranimit Cikli I dhe II]</p> <p>[Evidenca 20 – Kriteret e Pranimit në Ciklin e parë]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, konstatohet se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në mënyrë rigorozë gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të UT: Statuti, Rregullore. Kuotat përcaktohen gjithmonë në përputhje me infrastrukturën reale ekzistuese duke siguruar cilësinë dhe standardet ligjore dhe duke respektuar gjithë kategoritë e njohura shoqërore të kandidatëve (brenda vendit, nga trojet, me aftësi të kufizuara, jetimet, shtetas të huaj, romë, kandidatë për transferim studimesh, kandidatë për programe të dyta studimi etj.)</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 19 – Kuotat e Pranimit Cikli I dhe II]</p> <p>[Evidenca 20 – Kriteret e Pranimit në Ciklin e parë]</p>

<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në bashkëpunim me DRAP dhe ZVA, FSHN dhe Departamenti i Informatikës, organizojnë me nxënësit – maturantë të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë takime informuese në “javën e informimit”. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/)</p> <p>Në këto takime merr pjesë personeli akademik, të cilët informojnë në detaje dhe qartësojnë nxënësit – maturantë mbi të gjitha programet e studimit që FSHN ofron, si dhe mbi procedurat dhe kriteret për t’u regjistruar si student në secilin program studimi. Informacionet për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen në website-in e FSHN (https://fshn.edu.al/Info/kritere; https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimet-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/). Në faqet e FSHN dhe Departamentit të Informatikës, gjenden dhe informacione publike në lidhje me programin e studimit, organizmin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 19 – Kuotat e Pranimet Cikli I dhe II] [Evidenca 20 – Kriteret e Pranimet në Ciklin e parë]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga vizita në Institucion del që Departamenti i Informatikës ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në rregulloren e programit të studimit i cili është dhe i publikuar në faqen web. Gjithashtu, ky informacion jepet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet javës orientuese në fillim të studimeve. Informacioni jepet edhe nëpërmjet vetë personelit akademik për çdo disiplinë bazuar tek syllabusi i saj apo dhe nga Kujdestari Akademik i çdo viti që caktohet çdo fillim viti akademik për çdo vit studimi. Njëkohësisht, këto</p>


	<p>informacione që studenti i merr drejtpërsëdrejti apo dhe të tjera shtesë që lidhen dhe me infrastrukturën e FSHN, studenti mund ti marrë edhe nëpërmjet faqes web të FSHN dhe Departamentit.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në bazë të evidencave të paraqitura, rezultojnë që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimeve të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë ky informacion gjendet në Statutin dhe Rregulloren e UT. Duke u mbështetur në këto dokumente ligjore, Departamenti i Informatikës disponon një procedurë transparente dhe rigorozë për njohjen e studimeve të mëparshme.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 111 - Ekuivalentime Kategoria Transferime Degë të Dytë]</p> <p>[Evidenca 112 - Shqyrtimi i Dosjeve Degë II Transferime Cikli I Cikli II]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga personeli akademik përkatës ashtu edhe nga Kujdestari Akademik në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga Rregullorja e UT apo e Programit të studimit, apo syllabuset e disiplinave që gjendet në faqen web. Informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve. Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo dhe me gojë. Pikët konvertohen në notë mbi bazën e intervaleve plotësisht të përcaktuara në syllabusin e lëndëve. Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim dhe gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimit në rast se lind nevoja në afatet kohore dhe me mënyrën e përcaktuar në Rregullore.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p>

	<p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezulton që studentët e vitit të tretë informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga Kujdestari Akademik dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit. Gjithashtu ky informacion merret edhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UT, Rregulloren e programit të Studimit si dhe ekziston dhe Rregullorja e Diplomimit. Departamenti, edhe nëpërmjet kujdestarit akademik të studentëve, i informon ata rreth procedurës dhe llojit të provimit të formimit të parashikuar. Informacion që gjendet edhe në rregulloren e vet programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[Evidenca 6 – Rregullore e UT]</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udnëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni, në rang universiteti, por edhe njësie kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Tiranës, dhe në veçanti ato të ofruara në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Njëkohësisht, Universiteti i Tiranës, FSHN, në bashkëpunim me drejtoritë vendore rajonale të arsimit para-universitar, dhe përfaqësues të departamentit të Informatikës, organizojnë takime me maturantët në shkollat e mesme kryesisht në periudhën Mars-Maj, që është periudha para plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve. Kjo gjë bëhet edhe në panairin e universiteteve apo Ditët e hapura të informimit të maturantëve të organizuara në rrethe të ndryshme. Gjithashtu, gjithë ky informacion publikohet edhe në faqen web. (https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin edhe në vijim të vitit nëpërmjet Kujdestarit Akademik, zyra e këshillimit dhe karrierës edhe nga secili personel akademik. Njëkohësisht këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga faja web e FSHN dhe e Departamentit, ku ata mund të njihen gjithashtu edhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion është dhe sekretaria mësimore dhe dega e IT së FSHN. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar për këto elemente.</p> <p>[Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni rezulton të merret në Javën Orientuese në javën e parë të vitit akademik, merret nga çdo titullar i lëndëve, i cili informon në detaje strukturën, përmbajtjen, frekuentimin, vlerësimin, kreditet, objektivat, veprimtaritë formuese dhe qëllimet e lëndës. Studentë këto informacione mund ti marrin edhe nëpërmjet faqes web, nëpërmjet sistemit elektronik ndërmjet sekretarisë mësimore dhe bibliotekës së FSHN.</p> <p>Megjithatë nuk ka një udhëzues praktik për kandidatët për student, të cilët të marrin informacione të nevojshme dhe të plota për mundësitë e ofruara në këtë program studimi apo edhe në të tjera të kësaj njësie bazë dhe kryesore.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në të ardhmen të mund të ndërtohet një Udhëzues Studimesh për programin e studimeve me gjithë informacionin e nevojshëm: planin mësimor syllabuset, objektivat formuese dhe perspektivat e punësimit, personelin akademik të angazhuar, adresa komunikimi, detyra dhe të drejta të studentëve, rregulla të ndryshme etj. ku jo vetëm studenti por më shumë kandidati për student, të marrë</i></p>



	<p><i>informacion të plotë dhe të mjaftueshëm për zgjedhjen e formimit universitar</i></p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p> <p>[https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-axenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Rezulton që organizmi kryesor që merret me informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësinë e punësimit është “DSBCK” pranë FSHN. Ka dhe studime të tregut në rang universiteti. Mbështetja institucionale është nëpërmjet këshillimit të DSBCK dhe nëpërmjet panairove të karrierës apo punës të organizuara nga UT.</p> <p>Këtu ndihmon mjaft edhe marrëveshjet institucionale me kompani të ndryshme gjatë së cilës studentë kryejnë internshipe individuale, por jo në kuadër të programit mësimor. Kjo pasi programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni nuk parashikon lëndë “Praktikë Profesionale”. Bazuar edhe në takimet me studentët por edhe nga statistikat e vëna në dispozicion, studentët e diplomuat në këtë program studimi, zgjedhin të vazhdojnë karrierën e tyre studentore me studime të ciklit të dytë. Pavarësisht se gjatë kësaj kohe mund të jenë angazhuar me kohë të pjesshme në marrëdhënie pune në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>Në kuadër të rritjes së njohurive të tregut të punës, por edhe monitorimit të tyre nga institucioni, ne si GVJ, gjykojmë se shtimi i një lënde “Praktikë Profesionale” në planin mësimor, do të ndihmonte studentët në përshtatje më të mirë në tregun e punës, por edhe në kuptimin e rëndësisë së argumenteve të trajtuar në këtë program studimi.</i></p> <p>[Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p> <p>[Evidenca 10 - Studimi i Tregut të Punës UT 2018]</p> <p>[Evidenca 11 - Studimi i Tregut të Punës Janar 2022]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Ka disa forma nëpërmjet të cilave studentët informohen për procesin mësimor dhe elementët e tij apo infrastrukturën dhe shërbimet prej saj që lidhen me procesin mësimor: nëpërmjet kujdestarit akademik, faqes web të fakultetit dhe departamentit, stendës informative në hollin e departamentit, platformave online të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të</p>	<p>Konstatohet që përdoren disa forma të informimit të studentëve për programin e studimit: nëpërmjet kujdestarit akademik, personelit akademik përkatës të çdo disipline, faqes web të fakultetit dhe departamentit, nga komunikimi</p>

informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	elektronik nëpërmjet adresave e-mail me domain institucional dhe platformave online. [Evidenca 9 – Syllabuset Bsc. TIK 2020-2021] [Evidenca 41 – Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Gjithë baza e të dhënave dhe statistikave përkatëse lidhur me studentet deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria mësimore për të gjitha vitet. Dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomës. Këto të dhëna arkivohen mbi bazën e ligjit mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore administron të gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar të reregjistruar, të transferuar, të diplomuar, në program të dytë studimi, gjithë vlerësimet akademike të tyre, dhe mbi bazën e të cilave prodhohen statistikat apo dokumentacionet zyrtare për studentin, institucionin apo MAS. Mbështetur në [Evidenca 13 – Tabelat përmbledhëse për RVB Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, tab 21] dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është: 2019-2020 102 studentë; 2020-2021 102 studentë; 2021-2022 101 studentë; [Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore] [Evidenca 109 - Mesataret në hyrje]
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga	Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u

<p>pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>bazuar rregulloren e UT dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Megjithatë, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe në takimin me stafin akademik, u vu re se informacioni mbi detyrimet lëndore administrohen nga pedagogu i lëndës dhe jo nga sekretaria mësimore.</p> <p>Detyrime si frekuentimi, zhvillimi i laboratorëve apo i detyrave/projekteve të kursit, detyrime të cilat janë parakusht për lejimin në provim, administrohen vetëm nga pedagogu i lëndës sikurse saktësohet në nenin 15 të rregullores së programi të studimit. Këto të dhëna nuk depozitohen në sekretarinë mësimore. Pra sekretaria mësimore nuk administron të dhëna rreth detyrimeve të studentëve si parakusht për lejimin e tyre për të testuar njohuritë e lëndës (provim). Kjo situatë mund të bëhet problematike për student të cilët nuk i shlyejnë detyrimet lëndore në sezonin kur e kanë frekuentuar atë, por i shlyejnë në sezonet apo në vitet pasardhëse akademike. Si në rastin e studentëve që mund të jenë me transferim, studentë që mund të jenë përsëritës, apo edhe në rastin kur ndryshohet pedagog i lëndës.</p> <p>[Evidenca 2 – Rregullore e Programit Bsc. TIK] [Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Rezultatet e studentëve pasqyrohen në procese verbale të provimeve të secilës lëndë nga pedagogët e tyre dhe njëkohësisht ato pasqyrohen edhe në bazën e të dhënave të sekretarisë mësimore si edhe në regjistrin themeltar. Rezultatin në provim studenti e merr nga pedagogu i lëndës përkatëse. Gjithashtu, i mundësohet në çdo moment aplikimi pranë sekretarisë mësimore për vërtetim notash.</p> <p>Të dhënat në “Regjistrin themeltar”, në “Regjistrin e arritjeve akademike të studentëve” dhe në “Regjistrin e Diplomave” janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin.</p> <p>[Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT] [Evidenca 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe</p>	<p>Si një detyrim ligjor kundrejt ministrisë përgjegjëse për arsimin, Universiteti i Tiranës, mbi bazën e raporteve të</p>

<p>cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>hartuara nga njësitë kryesore, harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, në të cilin analizohet dhe vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore, ajo shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. Raporti vjetor FSHN, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njësive bazë përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Në këto raporte pasqyrohen edhe masat/rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Ndër treguesit bazë të cilësisë së mësimdhënies në analizë është mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në këtë program studimi, si dhe kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve. Në raportet vjetore të departamentit paraqiten rezultate analitike mbi numrin e të regjistruarve, dhe të diplomuarve të programit të studimit. Gjithashtu propozohen dhe masa/rekomandime për përmirësime të procesit mësimor.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021] [Evidenca 92 - Raporti i Vlerësimit të Lëndëve Semestri I 20-21] [Evidenca 96 - FSHN Raporti Shkencor 2018-2019] [Evidenca 106 - Vendim nr.54-1 datë 20.12.2021 Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së UT 2020-2021]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UT, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i etikës. Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional. Studentët janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen periodikisht me ta.</p> <p>Megjithëse institucioni ka të përcaktuar në aktet rregullatore përfshirjen e studentëve, angazhimi i tyre real, është i ulët. Edhe në vlerësimin e aktiviteteve universitare nëpërmjet anketimeve, pjesëmarrja e studentëve është në numër të ulët kundrejt totalit të studentëve. Kjo përbën edhe një bazë të ulët statistikore për vlerësimin korrekt të rezultateve të pyetësorëve.</p> <p><i>Mbetet si detyrë nxitja e pjesëmarrjes më të madhe të studentëve në procesin e pyetësorëve duke siguruar në këtë mënyrë një feedback më të mirë, të plotë dhe real që të shërbejë si bazë e saktë statistikore.</i></p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimit”, rezulton që është i hartuar mbi bazën e VKM 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar, i shtrirë në 3 vite akademike, 6 semestra. Çdo semestër ka 30 kredite dhe një ngarkesë prej rreth 20-21 orësh në javë në auditor dhe harmonizim të formave të vlerësimit brenda një ngarkese normale. Gjithashtu edhe njohja e plotë ose e pjesshme e studimeve të mëparshme nëpërmjet transferimit të krediteve përkatëse të fituara më përpara në IAL tjetër, kryhet konform Statutit të UT.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 7 – Plani Mësimor Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit është e garantuar me pjesëmarrjen reale të tyre në organet kolegjinale të përmendura më sipër, ku ata kanë mundësinë të shprehin mendimin dhe sugjerimet e tyre. Njëkohësisht ata kanë mundësi edhe gjatë kryerjes së pyetësorëve në nivel departamenti dhe fakulteti, por edhe në kontaktet që kanë me Kujdestarin Akademik të vitit përkatës. Gjithashtu, nga biseda e GVJ me studentët, u konstatua që ata shprehin këto sugjerime dhe mendime në Këshillin Studentor. [Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p>

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga pikëpamja ligjore, në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e programit të studimit, studentëve ju garantohet plotësisht mundësia për të ankimuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe rezultatin në to, me një procedurë plotësisht të përcaktuar. Nga biseda e GVJ me studentët, rezultoi që kjo realizohet në realitet konform rregullores.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Bazuar tek dokumentet kryesore zyrtare ligjore të UT: Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj. funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: zyra IT, Njësia bazë, Kujdestari akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e FSHN, Sekretaria Mësimore. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 36 – Paketa e Instrumenteve të Cilësisë] [Evidenca 41 – Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Rezultoni që studentët informohen, këshillohen, asistohen në lidhje me çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit, nëpërmjet rregulloreve institucionale të publikuara në faqen web të Universitetit të Tiranës dhe në atë të FSHN-së. Në faqen web të Fakultetit të Shkencave të Natyrës gjenden edhe informacione të tjera që lidhen me procesin mësimor dhe infrastrukturën përkatëse në shërbim të studentëve. Në stendat informative ka të afishuara detaje lidhur me orarin mësimor, datat e provimeve, oraret e</p>

	<p>konsultimeve me personelin akademik. Gjithashtu, kujdestari akademik i vitit përkatës është një tjetër burim i vazhdueshëm informimi dhe këshillimi. Po ashtu, sekretaria mësimore është kontakti i parë dhe i vazhdueshëm për informacion për studentët. [Evidenca 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, nuk ka të parashikuar praktikë profesionale, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere.</p> <p>Institucioni ka të ngritur degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës e cila kë edhe përgjegjësinë së bashku me njësinë bazë, të orientojë studentët drejt karrierës së tyre profesionale. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët, u vu re se kjo njësi informon studentët kryesisht me anë të postës elektronik rreth mundësive për punësim apo intershipe. Megjithatë nuk ka një qasje të orientuar rreth këshillimit të studentëve për qasjen që duhet të kenë në fillimin e karrierës së tyre profesionale. Kjo edhe si rrjedhojë e numrit të ulët të personelit të angazhuar në këtë sektor.</p> <p>Për të rritur cilësinë e shërbimit të këshillimit të karrierës, mendojmë se institucioni duhet të rrisë përfshirjen e kësaj njësie në takime jo vetëm virtuale por edhe në auditor me studentët jo vetëm për të parashikuar njoftimet e kompanive për punë apo intershipe, por edhe për ti orientuar ata rreth tregut të punës, mundësive të zhvillimit profesional apo krijimin e start-up apo kompani në fushën e këtij programi studimi. [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p>								
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia që informon, këshillon dhe orienton studentët gjatë studimeve deri në diplomim me kontakte të drejtpërdrejta ose me material informuese, edhe në ciklin e dytë dhe më pas duke mbledhur të dhëna për punësimin e tyre edhe pas diplomimit është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Gjithashtu UT organizon në mënyrë periodike edhe panairët e punës ku studentët mund të marrin informacione direkt nga punëdhënësit të ndryshëm.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1720 783 1825">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="783 1720 979 1825">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="979 1720 1176 1825">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1176 1720 1372 1825">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1825 783 1883"></td> <td data-bbox="783 1825 979 1883"></td> <td data-bbox="979 1825 1176 1883"></td> <td data-bbox="1176 1825 1372 1883" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Link për burime	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton që UT në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj, ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Është miratuar Manuali i Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohen qartë parimet dhe procedurat për zbatimin e tij. Janë ngritur strukturat në rang universiteti siç janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës etj. funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tyre janë të përcaktuara në Statutin e UT.</p> <p>Gjithashtu, në vijim janë ngritur strukturat në rang njësie kryesore, siç është Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC apo DSBCK), e cila ndër të tjerash në bashkëpunim me Zv. Dekanin përkatës që mbulon Ciklin e parë dhe të Dytë të studimeve, organizon pyetësorët me studentët për cilësinë e mësimdhënies për disiplinat e programit të studimit, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. NJSBC harton raportet e vlerësimeve.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT] [Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik] [Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin</p>	<p>Në UT, është funksional KPSSC si struktura përgjegjëse e ngarkuar nga Senati Akademik për të ndjekur dhe garantuar</p>

<p>e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>plotësimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo strukturë përbëhet nga 11 anëtarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë, ku FSHN përfaqësohet me 1 anëtar personel akademik. UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si strukturën ndihmëse akademike që mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore.</p> <p>FSHN ka ngritur si strukturë funksionale, Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), e cila është në varësi të Dekanit, përbëhet nga dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist dhe veprimtaria e së cilës kryhet e bazuar në “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumenteve të Cilësisë”, të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës. Nga verifikimi në realitet, rezultoi funksionale gjithë veprimtaria e saj.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT] [Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik] [Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UT, si detyrim ligjor, në 2018, ka kryer vlerësimin e brendshëm dhe më pas atë të jashtëm institucional të cilësisë, proces që u mbyll me akreditimin institucional për 4 vite akademike. Në këtë moment, është në zbatim instrumenti tjetër i sigurimit të cilësisë, akreditimi i programit të studimit. Është kryer vlerësimi i brendshëm, dhe është në proces vlerësimi i jashtëm.</p> <p>Nga evidencat përkatëse, rezultojnë që UT përgatit raportin vjetor mësimor-kërkimor për analizën e programeve të studimit dhe kurrikulave dhe përmirësimin e tyre në masën 20%, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të instrumenteve të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë etj. Njëkohësisht, rezultojnë që UT ka hartuar gjithashtu planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024.</p> <p>Siç rezultojnë dhe nga evidencat dhe bashkëbisedimi gjatë vizitës së GVJ në FSHN, DSBCK bashkëpunon dhe bashkërendon punën me departamentin për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të</p>

	<p>realizuar vlerësimin e brendshëm, ftohen studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit të studimit. Njëkohësisht, Departamenti i Informatikës përpilon analizat vjetore ku ndër të tjera në të përfshihen edhe tipet e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik dhe konkluzionet përkatëse. Ne bazë të tyre, hartohet nga Departamenti dhe plani i masave për përmirësim .</p> <p><i>Megjithatë, mendojmë se institucioni duhet të gjejë mekanizmat e përfshirjes më të madhe të studentëve në plotësimin e anketimeve në mënyrë që përgjigjet e tyre, në numër, të përbëjnë një bazë të mjaftueshme statistikore për të përfaqësuar mendimin e studentëve.</i></p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT] [Evidenca 57 – Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018] [Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik] [Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Siç rezulton nga evidencat përkatëse dhe nga vëzhgimi gjatë vizitës në institucion, Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Informatikës harton dhe në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe panin e masave për përmirësim te mundshme.</p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 1861 778 1957">Përmbushet</td> <td data-bbox="783 1861 970 1957">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="975 1861 1161 1957">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1166 1861 1366 1957">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të Ciklit të parë, rezulton që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës etj.</p> <p>Njëkohësisht, në nivel njësie kryesore, është ngritur dhe funksionon realisht Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Në këtë kuadër, dhe në mbështetje edhe të njësive të mësipërme, koordinimi i Përgjegjësit të Departamentit me zv. Dekanin që mbulon Ciklit të Parë të studimeve dhe zv. Dekanin që mbulon kërkimin shkencor, ndihmon në realizimin e analizave të punës mësimore-kërkimore dhe hartimin e raporteve përkatëse, të cilat më pas integrohen në raportimet vjetore si FSHN.</p> <p>Për një analizë më efektive, bazuar edhe në ndryshimet e shpejta teknologjike në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe në ngarkesën administrative të drejtuesit të njësisë bazë, monitorimi dhe rishikimi i programit të studimit bazuar kryesisht vetëm në analizën e drejtuesit të njësisë kryesore, nuk rezulton efektiv. Kjo bazuar edhe në numrin e lartë të programeve të studimit që ofron kjo njësi bazë (tetë programe në total) dhe angazhimeve të tjera administrative të kërkuara prej drejtuesit të saj.</p> <p><i>Ne si GVJ propozojmë që për të rritur efikasitetin e monitorimit dhe rishikimit të programeve të studimit, do të ishte me interes ngritja e Këshillit të Programeve të Studimit (KPS) për çdo program studimi të ofruar. Ky këshill, i dedikuar për një program studimi, do të kishte fokusin e tij të mirë përcaktuar dhe rezultatet do të jenë më efektive në funksion të rritjes së cilësisë në tërësi të shërbimeve të ofruara në kuadër të vet programit të studimit.</i></p> <p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>[Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p> <p>Universiteti i Tiranës, si dhe njësitë kryesore përbërëse, kanë rregullore institucionale dhe formalisht të unifikuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë: raportet vjetore në rang departamenti dhe fakulteti e më tej në rang universiteti, që marrin në analizë punën mësimore-kërkimore; nga praktika konkrete të evidentuara, rezultojnë që ndiqen procedura standarde të bazuara në ligjin e arsimit të lartë, VKM, udhëzimet e MAS dhe dokumentet zyrtare ligjore të UT, për ndryshime në programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi. Gjithashtu, hartohen dhe zbatohen një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore të cilat rezultojnë pas plotësimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies i cili realizohet për disiplinat e programit të studimit në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve.</p> <p>[Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p> <p>[Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p> <p>[Evidenca 23 – Shkresë përcjellëse për raportet mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore – shkencore]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në FSHN përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të cilat bazohen në dokumentin “Paketa e instrumenteve të cilësisë” të miratuar nga Senati Akademik. Këto mekanizma përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – vlerësimin e lëndës nga studenti (pyetësor që plotësohet përpara provimit); – vlerësimi i studentëve që diplomohen (pyetësor që plotësohet përpara se të marrin diplomën për cilësinë e programit të studimit); – raporti i studentëve (pyetësor me studentët e diplomuar për cilësinë e arsimimit të tyre); – vlerësimi i pedagogut (pyetësor që plotësohet nga studentët përpara provimit); – Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (i cili plotësohet nga çdo personel akademik në fund të çdo semestri në lëndët ku janë titullarë duke kryer një vetvlerësim dhe analizë bazuar në përqindjen e

	<p>kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje);</p> <p>Prej tyre, prodhohen statistika për program studimi, për lëndët e programit të studimit, për metodat e mësimdhënies (rasti i veçante i përdorimit të platformës online në kohën e pandemisë) si dhe analiza për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programit mësimorë aty ku shihet e nevojshme. Të gjitha këto mekanizma janë të unifikuar dhe të përfshira në Manualin e Cilësisë, Paketën e instrumenteve të cilësisë të miratuara në Senatit Akademik.</p> <p>Problem mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Ndoshta duhet të shtohet në këto mekanizma, edhe një vlerësim nga vetë personeli akademik, lidhur me infrastrukturën apo elemente të tjera të organizimit të institucionit.</p> <p>[Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p> <p>[Evidenca 57 – Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018]</p> <p>[Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik]</p> <p>[Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p> <p>[Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Një ndër dokumentet bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e përmendura tek kriteri 3 më sipër, është raporti i veprimtarisë mësimorë-kërkimore të njësisë bazë, i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel njësie kryesore. Në këto raporte gjenden të analizuara statistika të studentëve të regjistruar për çdo vit, të diplomuar për çdo vit, të çregjistruar, aktiviteti kërkimor i personelit akademik, përmirësimi i infrastrukturës, ngarkesa mësimorë e personelit akademik, përqindja e kalueshmërisë dhe përqindja e të diplomuarve, të dhëna nga raportet e Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës lidhur me pyetësorët e studentëve etj.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020]</p> <p>[Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021]</p> <p>[Evidenca 24 – Raporti Vjetor i Departamentit të Informatikës 2021 – 2022]</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e</p>	<p>Të gjitha këto raporte të analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe raporti i DSBCK paraqesin përveç</p>

<p>pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet e DSBCK gjenden të publikuara edhe në faqen web të FSHN.</p> <p>Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik që bazohet tek Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, miratuar nga Senati Akademik dhe ku parashikohen të qarta parimet, procedurat, kriteret, periudhat e vlerësimit. Njëkohësisht, ky proces kryhet edhe për personelin ndihmës akademik që bazohet në Manualin “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” të miratuar nga Senati Akademik.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021] [Evidenca 24 – Raporti Vjetor i Departamentit të Informatikës 2021 – 2022] [Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Si elemente të rëndësishme të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, janë analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore të departamentit të cilat më pas integrohen në analizat në rang fakulteti kryhen periodikisht çdo vit. Gjithashtu, pjesë e vlerësimit të brendshëm, janë dhe analizat çdo vit të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës, mbi bazën e pyetësorëve, të cilat publikohen edhe në rubrikën e vet në faqen web të FSHN.</p> <p>[Evidenca 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020] [Evidenca 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021]</p>

	[Evidenca 24 – Raporti Vjetor i Departamentit të Informatikës 2021 – 2022]
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	<p>Përvoja e fundit e fituar nga UT gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm në 2018 në kuadër të akreditimit, ka shërbyer si një përvojë pozitive edhe për metodikën e punës por edhe për të formalizuar gjithë instrumentet e posaçme për vlerësimin e programit të studimit: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, Rregullorja “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës si dhe njësi kryesore për mbikëqyrjen e këtij procesi: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës në rang universiteti dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës në rang fakulteti.</p> <p>[Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p> <p>[Evidenca 57 – Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018]</p> <p>[Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik]</p> <p>[Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p> <p>[Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	<p>Nga verifikimi gjatë vizitës, rezultoi që në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies: analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore në rang departamenti, dhe më pas në nivel fakulteti të cilat pasqyrohen në raportet përkatëse ku analizohen të gjithë elementët matës të cilësisë; dekanati me strukturat e tij ushtrojnë kontrole mbi kryerjen e procesit mësimor përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore monitorojnë procesin e mësimin, realizimin e programit mësimor, veprimtarinë kërkimore-shkencore, realizimin e seanceve laboratorike të studentëve, procesin e provimeve, performanca e personelit akademik. Gjithashtu, nga ana tjetër, DSBCK realizon pyetësorët periodikë me studentët dhe harton analizat dhe raportet përkatëse të cilat publikohen edhe në faqen web dhe merren në analizë nga departamenti. Programi mësimor, mbi bazën e sugjerimeve të bëra, është fleksibël dhe pasqyrohen ndryshimet deri</p>

	20%. [Evidenca 93 - Shkresë përcjellëse e raporteve të pyetësorëve të zhvilluar për vitin akademik 2020-2021]			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	<p>Përdoren disa metoda dhe praktika të tërthorta vlerësimi: nëpërmjet pyetësorëve, merret mendimi dhe vlerësimi për cilësinë e programit të studimit nga studentët përpara diplomimit. Gjithashtu, merret dhe mendimi dhe vlerësimi i të diplomuarve për argumente që vlerësohen si kyçe për cilësinë e programit të studimit. Njësia bazë ka realizuar gjithashtu edhe një studimi tregu, përtej asaj të realizuar në nivel institucional. UT kryen në rang institucional analizë të tregut të punës, për të parë tendencën e tregut të punës për të diplomuarit në programet e studimit, vështirësitë dhe analizohen elementët që duhen përmirësuar në cilësinë e programeve të studimit. Gjithashtu, departamenti realizon në fund të çdo semestri pyetësorin “Raport i vetëvlerësimit të lëndës” nga secili anëtar i personelit akademik i cili ndihmon të evidentohen edhe përmirësimet që duhen të bëhen për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. Njëkohësisht, në procesin e vlerësimit të programit mësimor merr pjesë edhe personeli ndihmës akademik.</p> <p>Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të tërhequr mendim dhe vlerësim mbi programin e studimit dhe sa i përgjigjet ai tregut të punës janë dhe studimet e tregut të punës të organizuara nga Universiteti i Tiranës ku përfshihet dhe pjesa e Departamentit të Informatikës.</p> <p>[Evidenca 10 - Studimi i Tregut të Punës UT 2018] [Evidenca 11 - Studimi i Tregut të Punës Janar 2022]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të	Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm

<p>brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>[Evidenca 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës] [Evidenca 6 - Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm si dhe nga verifikimet gjatë vizitës, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë (Departamenti i Informatikës) dhe njësia kryesore (FSHN) me strukturat e saj. Roli i tyre është i mirë përcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësisë në UT. FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, kurse Departamenti ka përfaqësuesit e tij në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës. Në FSHN është ngritur dhe funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila organizon dhe mbikëqyr gjithë procesin e sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Studentëve ju garantohet pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në strukturat e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, ashtu dhe si faktor që jep mendime dhe vlerësime për përmirësimin e programit të studimit, qoftë direkt me anketimet, pyetësorët, procesit të këshillimit brenda Departamentit, ashtu edhe nëpërmjet Këshillit Studentor.</p> <p>[Evidenca 36 – Paketa e Instrumenteve të Cilësisë] [Evidenca 38 – Rregullore DSBC FSHN] [Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p>

	<p>[Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik]</p> <p>[Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]</p> <p>[Evidenca 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatën dhe konfidencialitetin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga evidentimi i bërë, rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/FSHN ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe “Java e Europës në Universitetin e Tiranës”. Gjithashtu mobilitetet Erasmus/+ kanë ndihmuar në këtë proces.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin e njësisë bazë, Departamenti i Informatikës, u vu re se organizon takime me studentët (kryesisht në kuadër të lëndës “Njohje me profesionin”) duke ftuar here pas here ish student të këtij programi studimi që janë në punë në sektorë të ndryshëm dhe të cilët në takime me studentët aktuale paraqesin përvoja të tyre apo dhe paraqesin tema nga sektori i tyre i punës. Kjo praktikë vlerësohet shumë pozitive për të motivuar studentët e këtij programi studimi në thellimin e njohurive të tyre profesionale sipas edhe eksperiencës së profesionistëve të formuar në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti organizon edhe leksione të hapura nga vetë personeli akademik ose dhe të ftuar nga jashtë vendit. [Evidenca 65 – Leksion i hapur “Bëhu një programues i suksesshëm”]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Pa përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UT/FSHN janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike ne faqen web te tij https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2.</p> <p>Në faqet web të FSHN dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Edhe njësia bazë, në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Vlerësojmë se gjithë rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që përpilojnë strukturat e institucionit respektojnë lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët dhe vetvlerësimi i personelit akademik. [Evidenca 94 - Miratimi i planit te veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UT-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, rezulton se Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës organizon aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes</p>

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion. Megjithatë, kjo nuk ka rezultuar e mjaftueshme për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve apo anketimeve në lidhje me të gjithë aspektet akademike dhe administrative të organizuara. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në këto anketime, do të rriste bazën statistikore për të bërë të vlefshme rezultatet e përgjigjeve nga ana statistikore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimi në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe atë kombëtar dhe nevojave të tregut të punës;
2. Angazhimi nga Departamenti i Informatikës i një personeli akademik të kualifikuar dhe të qëndrueshëm në vite, garanton një cilësi të mirë të procesit të mësimdhënies/nxënies;
3. Përpjekjet e vazhdueshme për kualifikim e shprehur kjo në titujt dhe gradat e fituara, në aktivitetin kërkimor dhe mobilitetet e ndryshme të stafit (trajtime dhe mësimdhënie) në kuadër të programeve europiane ndikojnë pozitivisht në cilësinë e programit të studimit;
4. Krijimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve të Departamentit me ish-studentë të programit të studimit, të suksesshëm në karrierat e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit, me institucione dhe kompani brenda vendit, ndikojnë pozitivisht në tërheqjen e studentëve në programin e studimit dhe motivimin e tyre gjatë studimeve dhe pas tyre;
5. Biblioteka e pasur dhe pajisur me literaturë fizike dhe online në mbështetje të procesit të mësimnxënies dhe kërkimit shkencor;
6. Institucioni ka të ngritura dhe funksionale njësi të posaçme dhe procedura për orientimin dhe këshillimin e studentëve, të cilat operojnë në vazhdimësi dhe përdoren nga studentët e këtij programi studimi;

7. Përfshirja dhe angazhimi i studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe sigurimit të cilësisë së tyre;

b. Pika të dobëta:

1. Nuk ka të parashikuar në kurrikul lëndën e “praktikës profesionale”; (*Standard II.1, kriteri 6; Standardi II.4, kriteri 2; Standardi V.3, kriteri 3*)
2. Literatura bazë dhe e rekomanduar e përdorur, jo gjithmonë është e përditësuar në edicione të viteve të fundit; (*Standard II.3, kriteri 6*)
3. Plani mësimor dhe syllabuset përkatëse nuk parashikojnë ndarjen në kredite të lëndëve në aktivitete didaktike si leksione, seminare/ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, etj dhe orëve përkatëse në auditor; (*Standardi II.3, kriteri 2, 6; Standardi II.4, kriteri 4*).

Rekomandime:

1. Të parashikohet futja në planin mësimor të lëndës “Praktikë Profesionale”;
2. Të përditësohen syllabuset e lëndëve me literaturë të azhurnuar, sidomos për lëndët e formimit karakterizues (pjesë e kompetencës së njësive bazë përgjegjëse);
3. Të rishikohen forma e paraqitjes së planit mësimor dhe syllabuseve duke ndarë ndahet numrin total të krediteve të një lënde sipas aktiviteteve formuese (leksion, seminar/ushtrim, laborator);
4. Të rritet numri i krediteve dhe orëve përkatëse mësimore për aktivitetet laboratorike duke përfshirë më shumë ambiente laboratorike;
5. Sekretaria mësimore, duhet t’u sigurojë të gjithë studentëve të diplomuar suplementin e diplomës së bashku me diplomën dhe jo vetëm kur studentët e diplomuar e kërkojnë atë;

Conclusions of the evaluation of the first program Bachelor in “Information and Communication Technology”

a. Strengths and Affirmations:

1. Study program in accordance with national and institutional development strategy based on needs of the labor market;
2. The engagement by the Department of Informatics of a experienced and stable academic staff over the years guarantees a good quality of the teaching/learning process;
3. Continuous efforts for qualification expressed in titles and degrees obtained, in research activity and various staff mobilities (training and teaching) within European programs positively affect the quality of the study program;

4. Creation and strengthening of relations and collaborations of the Department with former students of this study program, successful in their professional careers at home and abroad, with institutions and companies within the country, positively affect the attraction of students in the study program and their motivation during and after their studies;
5. The library is rich and equipped with physical and online literature in support of the learning process and scientific research;
6. The institution has established and functional special units and procedures for the orientation and counseling of students, which operate continuously and are used by the students of this study program;
7. Engagement of students in decision-making and advisory bodies in the framework of drafting, approval, review and improvement of study programs, teaching methods and ensuring their quality;

b. Weak points:

1. Lack of professional practice in the curriculum of the study program; (*Standard II.1, criterion 6; Standard II.4, criterion 2; Standard V.3, criterion 3*).
2. The mandatory and recommended literature used is not always updated in recent years' editions; (*Standard II.3, criterion 6*)
3. The study program and related subject syllabuses do not provide the split out of course credits into didactic activities such as lectures, seminars/exercises, laboratory, course assignments/projects, etc. and the corresponding hours in the auditorium; (*Standard II.3, criterion 2, 6; Standard II.4, criterion 4*)

Recommendations:

1. To include the "Professional Practice" course in the curriculum of the study plan;
2. Update subject syllabuses with up-to-date literature, especially for core training subjects (part of the competences of the department);
3. Review the presentation of the study plan and related programs, presenting the total number of credits for a subject, dividing it according to the didactic activities (lesson, seminar/practice, laboratory);
4. To increase the number of credits and relevant teaching hours for laboratory activities including more laboratory facilities;
5. The teaching secretariat, must provide all graduate students with the diploma supplement together with the diploma and not only when the graduated students ask for it;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushe n pjesërisht	Përmbushe n kryesisht	Përmbushe n plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X